



DRUNJTË VDESIN NË KËMBË

Allahu i Plotfuqishëm ka krijuar krijesa të panumërta, të mëdha e të vogla dhe të dobëta e të fuqishme. Secila nga ato ka veçoritë e saja që e dallojnë njëra tjetrën, madje edhe e zbukurojnë atë krijesë **“Qoftë Lartësuar Allahu, Krijuesi më i përsosur”**. Ato po ashtu ndahen edhe për sa i përket vullnetit, disa prej tyre nuk kanë të drejtë vendimmarrjeje ndaj edhe nuk do merren në përgjegjësi kurse disa (njerëzit dhe xhindet) kanë të drejtën e vullnetit dhe të marrjes së vendimit, ndaj dhe do të merren në përgjegjësi për veprimet e tyre. I lumtur dhe i shpëtuar prej tyre është ai që njohu meritat e Krijuesit të vet dhe u mundua singërisht t’i realizojë ato ndërsa i dëshpëruar dhe i falimentuar do të jetë ai që harroi për vetveten se nuk është tjetër veçse një krijesë e dobët që vazhdimisht ka nevojë për përkrahjen e Krijuesit e cila fitohet vetëm pas të qenit rob i përkushtuar i Tij, normalisht përkrahjen e cila nuk këputet me ndaljen e frymëmarrjes por vazhdon në amshueshmëri kur të arrijë në xhenetet e larta.

Njeriu krahas virtyteve që ka shpesh di të jetë i padrejtë dhe injorant. Në rast se nuk e edukon shpirtin e tij me mësimet hyjnore do të bëjë gjithçka që mundet me aftësinë, pasurinë, fuqinë dhe shoqërinë e tij pa pasur brengën nëse vepron drejtë apo jo. Shpesh arrijnë që me pasuri të mposhtin dijen dhe shkencën, me fuqi të mposhtin të drejtën dhe me shoqërinë të zbukurojnë veprimet e tyre që të ndihen sadopak të lumtur. Për një kohë mund të duket se vazhdimisht po forcohen, nuk do përjetojnë as thyerje e as shuarje për shkak të epërsisë që e rrisin në vazhdimësi. Mirëpo, kur të fillojnë krisjet dhe lëkundjet atëherë, për të ruajtur pamjen e jashtme do të intensifikojnë aktivitetin e tyre duke thurur vargje të kënaqësisë, shkruajnë lëvdata, organizojnë manifestime dhe përrurime, ndërtojnë tempuj me shpresën të mos i harrojë ardhmëria etj. Çdoherë kjo sjellje është mënyra më e mirë për të mbuluar atë çfarë po ndodhë në realitet. Të atillët vërtetë arrijnë të hijeshojnë të jashtmen por e dinë mirë gjendjen e tyre të brendshme, duan të duken të fortë, të lartë dhe të pamposhtur por çdokush e di se drunjtë vdesin në këmbë.

S’ka dyshim se jeta e vërtetë dhe epërsia në dynja e ahiret u takon atyre që pranian dritën e udhëzimit nga Allahu përndryshe tek Allahu do të llogariten të vdekur edhe pse frymojnë dhe në errësirë edhe pse ka drita.

“A barazohet i vdekuri që Ne e ngjallëm dhe i dhamë dritë me të cilën ecën midis njerëzve, me atë që është në errësirë e nuk mund të dalë prej saj?! Kësisoj, jobesimtarëve u duken të bukura veprat që bëjnë!” (Enam 122).

Në emër të redaksisë: Omer Berisha

AKTUALE

3-4 | KRYQOMANIA SI PJESË E SPEKTAKLIT POLITIK GREK

5-7 | GRUEVSKI DHE PESË MËSIMET E TIJ PËR
MUSLIMANËT

8-12 | GULÇIMI I FARAONËVE

13-15 | BLIC LAJME

AKIDE

16-19 | JAM I KËNAQUR ME ALLAHUN SI ZOT

DRITARE

20-21 | TREGIMI I KATËR GRAVE

22-25 | TELEVISIONET I TEJKALOJNË PULLAT E KUQE

FIKH

26-31 | ADOPTIMI I FËMIJËVE

EKONOMI

32-35 | RREGULLAT DHE PARIMET E INVESTIMIT

FAMILJA

36-38 | SPEKTAKLI I BESIMTARES

39-41 | ROLI ROBËRUES I MEDIEVE

42-45 | VAJZA JOTE ËSHTË BËRË GRUA, A E BESON?!

INTERVISTA

46-47 | INTERVISTË ME AKTORIN SHQIPTAR NGA SHKUPI, ISMET RAMADANI
“JETA PA ISLAM ËSHTË BARAZI ME ZERO”

48-49 | INTERVISTË ME AKTORIN E NJOHUR NGA KOSOVA, NASER RAFUNA
“DO TË PENDOHESHA SIKUR TË MOS JEM I PENDUAR”

HADITH

50-53 | NJERËZ TË MËDHENJ RRALLË LINDIN

THESARE

54-56 | BUZËQESHJA NË PRAKTIKËN E PROFETIT

FETVA DHE KONSULTIME

57-60 | A LEJOHET NGRITJA NË KËMBË PËR NJERËZIT?

REDAKSIA

Kryeredaktor: Omer BERISHA

zv. kryeredaktorë: Agron TERZIQI dhe Justinian TOPULLI

Anëtarë të redaksisë:

Ismail BARDHOSHI, Bledar HAXHIU, Lulzim SUSURI, Talha KURTISHI, Genc PLUMBI,
Ali SHABANI, Agim BEKIRI, Driton LEKAJ, Llokman HOXHA, Rashit ZYLFIU dhe Hajrush MANI

Bashkëpunëtorë: Ahmed KALAJA, Ekrem AVDIU dhe Enis RAMA

Redaktor gjuhësor: Roald HYSA

Ballina: Dorlir KRAJA (ENSARTDESIGN Studio)

Boton: AlbIslam

Adresa: rr. Petre Georgiev nr. 63 | Çair | Shkup 1000
e-mail:

albislam@albislam.com

albislam@gmail.com

sms: +389 71 806 114 | fax&tel: +389 2 26 12 932

Revista është e regjistruar pranë Agjencisë për

Informata të Maqedonisë nr. 02-124/2

ISSN: 1409-6250

Tirazhi: 2000

ABONIMI NJË VJEÇAR
Për Maqedoni: 600 den, Jashtë vendit: 20 euro
(në çmim janë të përfshira edhe harxhimet postare)
e-mail: albislam.abonues@gmail.com
ALBISLAM DOOEL
xhirollogaria: 300000002770453
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (denarë)
xhirollogaria: 0270100245547
Komercijalna Banka A.D. - Skopje (euro etj.)
Rr. "Kej Dimitar Vlahov" 4
S.W.I.F.T.: KOBSMK2X
IBAN: MK07300701002455425
numri tatimor: 4030008038784

KRYQOMANIA SI PJESË E SPEKTAKLIT POLITIK GREK

Një garë për të vënë kryqe nëpër vende të dukshme me sa duket tashti po jep frytet e veta. Kryqet e vendosura në jug të vendit dhe skandalet e varrezave në Boboshticë të Korçës dhe Kosinë të Përmetit konfirmuan shqetësimet e kahershme. Regjistrimi i popullsisë dhe pretendimet e konsullit grek Ikonomu në përvjetorin e OMONIA-s i bëjnë akoma më të qarta pretendimet e grekëve edhe aty ku nuk ka grekë.

SHKRUAN: ROALD A. HYSA

Tashmë **Regjistrimi i Popullsisë** është kthyer në një mollë sherri ndërmjet atyre që e duan këtë vend dhe pretendimeve helene për jugun e vendit tonë. Vërejmë gjithashtu se 2 janë pikat më të nxehta për momentin: varreza e Boboshticës në Korçë, ndërsa tjetra është

varreza e Kosinës. Veçanërisht këto të dyja nuk prekin thjesht vetëm ndjesitë e muslimanëve shqiptarë, por të të gjithë shqiptarëve në veri e në jug, me qenë se ato prekin ndjesitë kombëtare të tyre dhe nuk janë një gjë e thjeshtë për t'u tejkaluar. Gjithashtu mosrespektimi i treguar ndaj varreve të shqiptarëve në Boboshticë të Korçës dhe në Kosinë të Përmetit me pretendimin se ato janë varre

grekësh është një tjetër precedent i rrezikshëm politik ndaj kombit shqiptar dhe të gjithë përpjekjeve të rilindësve dhe patriotëve tanë të shquar, që luftuan për ngritjen e Shtetit Shqiptar si, Jani Vreto, Pashko Vasa, Naum Veqilharxhi, Papa Kristo Negovani, Mihal Grameno, Themistokli Gërmenji, Luigj Gurakuqi, Ismail Qemal bej Vlora, Hafiz Dalliu e shumë të tjerë, që sakrifikuan jetën e tyre për atdheun. Kjo po vërehet ditët e fundit, kur konsulli grek në qytetin e Korçës i deklaroi këto varreza si të “grekëve”, e citojmë: *“Grekë, mos u trembni nga regjistrimi i popullsisë, të shpallni origjinën reale dhe të gjithë atyre që janë në dyshim dhe me frikë dhe pyesin veten jam me siguri grek, ju them një gjë, shkoni në varreza dhe shikoni varrezat e etërve dhe gjyshërve tuaj dhe gjuhën në të cilën janë të shkruar dhe merrni vendimin tuaj. Janë në gjuhën greke.” “Po, ekzistojnë grekë në Korçë. Po, vllehtë janë grekë”*. Gjithashtu vija e kryqeve të vendosura në Përmet e Korçë, ku në fund vërehet se është ndjekur vija e rrugës nacionale dhe kryqet të gjithë kryesisht janë të vendosura pranë rrugëve (Boboshticë, Kosinë, Lipë, Kutal, Çarshovë, rruga nacionale Jergucat-Gjirokastër etj), kjo lloj vendosje na kujton krejtësisht një vijë të re të Teodosit, ku kërkohet të dallohet ortodoksia me helenizmin e saj. Kohët kanë ndryshuar dhe e vërteta nuk mund të fshihet me shoshë, pavarësisht këmbënguljes helene për t’i bërë realitet pretendimet mbi 200-vjeçare ndaj trojeve me popullsi të pastër shqiptare. Është për t’u lavdëruar përpjekja e nënkryetarit të Këshillit të Lartë të Drejtësisë Kreshnik Spahiu, i cili i raportoi dhe i denoncoi përpjekjet e forcave të ndryshme brenda vendit dhe administratës së Shtetit Shqiptar, të cilët i kanë ndihmuar me

dashje apo pa dashje synimet dashakeqe helene në jug të vendit për të ndryshuar kombësinë e për të rritur shifrat. Shifrat e minoriteteve mund të ndërrojnë, por përqindjet nuk është se mund të ndryshojnë sipas oreksit të politikanëve grekë. Edhe propaganda e ulët, se këtë na e kërkon Evropa (regjistrimin e kombësisë dhe fesë) tashmë është një demagogji krejtësisht e pastër, sepse në radhë të parë është antikushtetuese sipas ligjeve të Shtetit Shqiptar e më pas regjistrimi në bazë etnie dhe feje nuk përfshihet në Rregulloren Evropiane të Parlamentit Evropian No. 763/2008 për regjistrimin e popullsisë. Këto dy pyetje janë shtuar nën presion në pyetësorin e përgatitur nga INSTAT dhe jo si standard për t’u plotësuar. Në Evropë nuk ka asnjë vend, ku shteti të ketë bërë një regjistrim mbi baza besimi dhe etnie, përveç rastit kur kjo gjë realizohet nga agjenci jo-shtetërore të specializuara, apo OJF të karakterit ndërkombëtar, të cilat nuk kanë ndërrarësi nga politika. Tashmë është plotësisht e qartë që politika greke bën presion mbi Qeverinë Shqiptare, duke i vënë si kusht regjistrimin e popullsisë (me baza kombësie e feje), si shkëmbim për procesin e integritetit të Shqipërisë në BE, ndërkohë që i duhet vetë Greqisë që të integrohet, meqë deri tani është i vetmi vend i BE-së, i cili nuk i njeh minoritetet etnike dhe fetare, madje i shkel të drejtat e tyre dhe kjo është konstatuar shumë më herët. Fakti që Politika Greke refuzon të njohë të drejtat e popullsisë çame dhe gjenocidin e ushtruar mbi të e konfirmon plotësisht këtë gjë. ■

GRUEVSKI DHE PESË MËSIMET E TIJ PËR MUSLIMANËT



Kemi nevojë për studim, planifikim, insistim në tërësinë e identitetit, në këmbëngulje, për zhvillimin e arsimit dhe për forcën e rinisë. Nëse nuk do të arrijmë t'i plotësojmë këto kushte do të mbetemi peng i veprimeve arbitrare, do të harrojmë se kush jemi

SHKRUAN: TALHA KURTISHI

Dituria dhe urtësia janë pronë e muslimanit, kudo që t'i gjeni, ju më shumë se të tjerët i meritoni. Këto fjalë

të urta m'u kujtuan para se të filloj me shkrimin duke konstatuar se fatkeqësisht se ndaj diturisë së dobishme dhe ndaj mësimave jetësore sillemi sikur ndaj rrobave për të cilat nuk kemi nevojë. Një bashkësi, e sidomos muslimanët, nuk

mund t'i arrijë synimet e vetdëshmimit dhe t'i realizojë aspiratat e prosperitetit, nëse nuk është vigjilente ndaj nevojës për dituri dhe njohuri. Edhe ndodhitë e fundit me të ashtuquajturin muze e realisht kishë në Kalanë e Shkupit e vërtetojnë akoma më shumë nevojën, që të jemi vazhdimisht në hap me planet, hartimet dhe strategjitë e atyre që thënë thjesht nuk na duan. Është fakt i pamohueshëm, se të gjitha veprimet e Gruevskit dhe parisë së tij janë të lidhura me kulturën, religjionin dhe identitetin, shkojnë në drejtim të imponimit të etnocentrizmit maqedonas dhe ngjyrosjen e realitetit fetar me ngjyrën e krishterimit ortodoks. Për detajet e kësaj strategjie nuk do të flas, e as që do të flas për shkallën e suksesit të këtyre projekteve. Atë që do ta bëj i inspiruar nga fjalja e përmendur në fillim të tekstit është se do të mundohem të nxjerr mësimet për të cilat ka nevojë muslimani, si individ dhe si bashkësi, nga mënyra se si Gruevski i planifikon e pastaj edhe si e realizon falsifikimin e realitetit shumëshkullor të Maqedonisë.

Mësimi i parë: Planifikimi, i cili vjen pas studimit të realitetit. Këtë e shohim qartë në programin e partisë së tij "Rimëkëmbja në 100 hapa", në vazhdimin e këtij programi "*Rimëkëmbja vazhdon*", në projektin Shkupi 2014, në ligjet për arsim, për stimulimin e natalitetit, më mënyrën se si ndahet buxheti i kulturës... Ai e ka kuptuar qartë se planifikimi i mirë është mënyra më e mirë për realizimin e synimeve që ato kanë. Nuk ka dyshim se për një botëkuptim të këtillë kanë nevojë edhe muslimanët e Maqedonisë. Veprimet që nuk mbështeten në studim nuk kanë fund të mirë, përfundojnë me zhgënjim dhe me asgjësimin e arritjeve.

“...Injorimi i forcës së rinisë nënkupton injorimin e forcës më të madhe lëvizëse dhe zhvilluese...”

Mësimi i dytë: Këmbëngulja në elementet e identitetit, në veçanti ato që kanë të bëjnë me fenë. Duke vërejtur momentin e krizës së identitetit, që po përjeton populli i tij dhe që po ballafaqohet me mohimin ndërkombëtar ai e kuptoi se duhet të punohet për ta forcuar identitetin. Ai gjithashtu kuptoi se element shumë i rëndësishëm i identitetit është religjioni, prandaj bëri që lufta për njohjen e KOM-it të bëhet pjesë e luftës për identitetin maqedonas. Me shpejtësi të madhe e përfundoi denacionalizimin e pronës së Kishës, priftërinjtë ortodoksë u bënë dekor i përurimeve, premtoi kishë në sheshin e Shkupit, filluan emërimet se Maqedonia është një vend biblik në të cilin gjendet Jerusalemi i Evropës Ohri. Ndërsa një fushatë që natyrshëm dhe me krenari e pranon përbërësin islam në identitetin e shqiptarëve, ende është i rrallë tek subjektet kryesore politike, që drejtojnë shqiptarët e Maqedonisë.

Mësimi i tretë: Këmbëngulja dhe mosdorëzimi. Vërejtje të shumta arritën në adresë të Gruevskit, lidhur me mënyrën se si ai mendon, drejton dhe ndërton Maqedoninë. Këto vërejtje hasën në vesh të shurdhër dhe ai vazhdoi të realizojë atë që mendon se është e drejtë.

Këto dy cilësi (Këmbëngulja dhe

mosdorëzimi) kanë vlerën e tyre, kur bashkohen me veprimet e drejta dhe me qëllimet fisnike. Nëse janë vetëm thjesht insistim dhe këmbëngulje pa të drejtë, atëherë ato nuk janë të dobishme. Këtë këmbëngulje në çështjet e drejta duhet ta posedojnë edhe muslimanët, të cilët nuk duhet të dorëzohen, por të vazhdojnë pa mëdyshje drejt realizimit të asaj që është aspiratë e drejtë dhe synimi i shëndoshë.

Mësimi i katërt: Zhvillimi i arsimit si bazë për prosperitet. Nuk do të flas se sa i suksesshëm është ky projekt, por ajo që duhet pranuar është fakti se motoja dituria është fuqi, dituria është forcë, është plotësisht e saktë. Më kujtohet një ligjëratë e dr. Abdul Kerim Bekkarit, i cili thoshte se zhvillimit të Koresë i kanë paraprirë reforma të mëdha në sistemin arsimor. Si pasojë e këtyre ndryshimeve eksporti i mallrave, që prodhon Korea për një ditë arrin shumën prej katër milionë dollarë. Nëse muslimanët dhe udhëheqësit e tyre arrijnë të krijojnë një forcë pune të arsimuar dhe të profesionalizuar, për të gjitha sferat e jetës, sukcesi do të jetë i pashmangshëm. Kushti i i vetëm i kësaj është insistimi për një arsim cilësor dhe me parimin e cilësisë dhe jo me parimin e sasisë.

Mësimi i pestë: Faktorizimi i rinisë. Fytyrat e qeverisë së Gruevskit janë fytyra rinore. Kjo s'do të thotë se ai u distancua plotësisht nga kuadrot e vjetra. Përkundrazi ata akoma janë pjesë e rëndësishme në vendimmarrje dhe udhëheqje. Ajo që duhet të pranohet si realitet është fakti, se Gruevski vendosi ta ballafaqojë rininë me sfidat e udhëheqjes,

ta shfrytëzojë rininë dhe elanin e tyre. Rinia është ardhmëria e popullit, prandaj edhe ajo duhet të aftësohet dalëngadalë dhe të kyçet në vendimmarrje e udhëheqje. Injorimi i forcës së rinisë nënkupton injorimin e forcës më të madhe lëvizëse dhe zhvilluese. Nëse arrihet të bashkohen forca e rinisë me përvojën dhe diturinë e të vjetërve, atëherë është bërë kombinimi i duhur për zhvillimin dhe përparimin. Një faktorizim i këtillë i rinisë është më se i nevojshëm edhe tek muslimanët e Maqedonisë.

Në fund mësimi i dobishëm është mësim i dobishëm pa marrë parasysh burimin e tij. Në situatën e krijuar në Maqedoni për muslimanët në përgjithësi dhe për shqiptarët në veçanti, ndjekja e këtyre parimeve që i nxora në pah nga mënyra e veprimit të Gruevskit janë më se të dobishme. Kemi nevojë për studim, planifikim, insistim në tërësinë e identitetit, në këmbëngulje, për zhvillimin e arsimit dhe për forcën e rinisë. Nëse nuk do të arrijmë t'i plotësojmë këto kushte do të mbetemi peng i veprimeve arbitrare, do të harrojmë se kush jemi, do të dorëzohemi para çdo kërcënimi, do të vazhdojë degradimi i arsimit dhe do të anashkalohet forca e rinisë... Prej Allahut varet sukcesi ynë. ■

GULÇIMI I FARAONËVE

Në ngjarjet e Tunizisë, Egjiptit dhe të Libisë gjejmë shembujt më të mirë për rolin e popujve në përgjithësi dhe të rinisë në veçanti, të refuzimit të korrupsionit dhe luftimit të padrejtësisë.



ABDULAZIZ IBËN MUHAMED ALU ABDULATIF

“O Allahu ynë, Ti ia more shpirtin e tani ndërprite traditën e tij tek ne. Ai na erdhi shkatërrues e turbullues, rritej me dorë të shkurtër, pasha Allahun asnjë kapistall i tij nuk garoi në rrugë të Allahut, ai krihte kokën, mburrej me ecje, hipte në minber, bërbëliste derisa ikte koha e namazit, as nga Zoti nuk frikësohej e as nga njerëzit nuk turpërohej, e dëgjonin njëqindmijë apo më shumë e askush nuk mund t'i thoshte: ‘namazi o njeri!’; pastaj Hasani shtoi: E si mund të flisnin, ndërsa kishte

shpatën e shkopin?”¹

Këto ishin fjalët e zotërisë së tabiinëve, Hasan Basriut, Allahu e mëshiroftë, pasi ra në *sexhde falënderimi*, kur i erdhi lajmi i vdekjes së Haxhaxh ibën Jusufit.²

Vdekja e tagutëve, humbja e pushtetit dhe rrëzimi nga karrigia, që ata pësojnë janë prej ligjeve dhe shenjave të Allahut, ku ne duhet të meditojmë dhe të marrim mësim. Ja siç po i vërejmë sisteme e qeveri në kulm të diktaturës, shtypjes e tiranisë, që pastaj vijnë në shok-situata dhe vërehen që janë sisteme të brishta, që bien si gjethet e vjeshtës. E gjithë çështja i takon vetëm Allahut, ajo që do Allahu do të jetë; e ajo që Ai nuk do, nuk mund të jetë. Allahu ka thënë: **“Thuaj: O Allah, Zotëruesi**

¹ Xhesas, Ahkamul Kuran (3/404).

² Abdulgani elMakdisi, libri atyre që u fshehën nga frika e Haxhaxhit, fq. 46.



i gjithë Pushtetit! Ti ia jep pushtetin kujt të duash dhe ia heq kujt të duash; Ti lartëson kë të duash dhe poshtëron kë të duash. Çdo e mirë është në Dorën Tënde. Ti je vërtet i Plotfuqishëm për çdo gjë” (Ali Imran 26).

Mirëpo ata faraonë e taguta nuk do të arrinin tiraninë e diktaturën pa ekzistencën e grupeve, që u japin besën e plotë dhe u përgjigjen verbërisht. Në fakt popujt e humbur janë ata që prodhojnë diktatorë dhe ua bëjnë të lakmuar tiraninë në çdo kohë dhe në çdo vend.³ Ndërsa popujt që u japin fëmijëve edukatën e trimërisë dhe të kurajës, nuk do të pajtohen me përçmimin dhe nuk do të qetësohen përpara padrejtësisë. Në

“...Lënia e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja nga frika e fitnes është prej sëmundjeve të dyfytësisë, që në të kaluarën e deri tashti...”

ngjarjet e Tunizisë, Egjiptit dhe të Libisë gjejmë shembujt më të mirë për rolin e popujve në përgjithësi dhe të rinisë në veçanti, të refuzimit të korrupsionit dhe luftimit të padrejtësisë.

Muhamed Gazali, Allahu e mëshiroftë, thotë: “I shikua me vëmendje revolucionet që u ndezën anekënd lindjes kundër pushtuesve të vendeve islame. Pamë se rinia ishin ata që iu futën nxehtësisë dhe morën barrën më të madhe, si dhe nxituan me entuziazmin e tyre të përflakur dhe me kurajën e mahnitshme, shkruanin vdekjen e armiqve dhe vizatonin për Umetin pamjet e flijimit dhe të sakrificës. Akoma rinia studentore apo ajo punuese janë benzina e lëvizjeve të lira, pararoja e kryengritësve ndaj çrregullimit e diktaturës dhe kibra e edukatorëve dhe e udhëzuesve.”⁴

Shumicën e djelmoshave – në Tunizi, Egjipt dhe Libi – nuk i bashkoi ndonjë parti apo ideologji e fshehtë dhe kjo ishte shkak i kurajës, qëndrimeve spontane dhe rezistencës së singertë... që moti, këtë realitet e kishin kuptuar abasidët kur krijonin shtetin e tyre, thirrësit e tyre i dërguan në Horasan, sepse aty kishte gjokse të shëndosha dhe zemra të zbrazëta.

³ Muhamed el Gazali, Mealumul Hak, fq. 239.

⁴ Meukibu Dave, fq. 49.

Ibnul Xheuzi duke folur për ngjarjet e vitit 100 H na përcjell, se Muhamed ibën Ali el Abasi thirrësve (përkrahësve) të shtetit abasid u kishte thënë: “Në Kufe janë shiat, në Basra janë ndjekësit e Osmanit që nuk luftojnë, ata thonë: bëhu Abdullah i vrarë e mos u bëj Abdullah katil, në Gadishullin Arab janë harurijunët (havarixhë), në Rika janë muslimanë, por në aleancë me të krishterët, në Sham nuk pranojnë bindjen ndaj askujt përveç ndaj bijve të Mervanit, në Mekë e Medinë mbisundojnë idetë e Ebu Bekrit dhe Omerit. Prandaj përqendrohuni në Horasan, sepse atje ka zemra të zbrazëta dhe gjokse të shëndosha, që nuk i kanë mbisunduar epshet e as nuk i kanë të shpërndara ideologjitë”.⁵

Kjo përmytje sado që të jetë përfshirëse dhe e zhurmshme, nëse ka si qëllim përmirësimin dhe largimin e prishjes, atëherë gjithsesi duhet të ndihmohet me shpejtësi çështja para se të ikë koha, siç kanë thënë: “Shanset ikin shpejt e kthehen rrallë”, prandaj islamikët duhet të derdhin gjithë mundin e tyre për të përmirësuar kahen dhe orientimin e këtyre protestave në pajtim me dispozitat fetare dhe dobite e përgjithshme. Nuk na ka hije të fshehim personalitetin tonë islam në mes këtyre ngjarjeve, nuk duhet të mungojë ligjërimi fetar sipas Kuranit për të kënaqur realitetin e tmerrshëm apo fuqitë e huaja...

Siç nuk i ka hije disave që u dedikohen dijes dhe davetit t'i japin përparësi fshehjes, të heshtin nga detyra e kumtesës së qartë dhe të shpresojnë shpërblimin në kësi situatash. Ata nuk duhet të heqin dorë nga luftimi i zullumit, sjellja e drejtësisë dhe njoftimi i njerëzisë të lirë me punë të mbara dhe devotshmëri... edhe më e keqe

“...Ngjarjet e Tunizisë, Egjiptit dhe Libisë zbuluan krizën e kuptimit të politikës sheri-atike (fikhu sijase sherije) te disa vëllezër tanë selefij..”

se kjo është që ata të gjejnë “arsyen”: largimi nga të gjitha fitnet, qofshin të dukshme apo të fshehta!

Lënia e urdhërimit në të mirë dhe ndalimit nga e keqja nga frika e fitnes është prej sëmundjeve të dyfytërisë, që në të kaluarën e deri tashti, dhe me këtë u përlyen disa fetarë qëmoti, por edhe sot... këtë e zbuloi Ibën Tejmiya kur tha: “Pasi urdhërimi në të mirë, ndalimi nga e keqja dhe xhihadi në rrugë të Allahut janë sprova, ku njeriu rrezikon të bjeri në fitne, dolën disa njerëz që i braktisnin ato kur i kishin vaxhib, me arsyen se duan të shpëtojnë nga fitnet”.

Për munafikët Allahu ka thënë: **“Disa prej atyre thonë: ‘Më lejo (të mungoj në luftë) dhe mos më vër në sprovë!’ Ja, ata ranë pikërisht në sprovë. Me të vërtetë, xhehenemi i përfshin mohuesit”** (Teube 49). Në tefsir përmendet se ky ajet zbriti për Xhed ibën Kajsin, kur e urdhëroi Profeti që të përgatitet për luftë kundër romakëve, e ai tha: “O i Dërguari i Allahut, unë jam një burrë që nuk mund t'i përballoj femrat dhe kam frikën nga sprova e grave të asaj race, më lejo pra të mungoj dhe mos lejo të bie në sprovë”; dhe atëherë zbriti ajeti i sipërpërmendur. Pra, t'i kthesh shpinën xhihadi të detyruar dhe arsyetimi që ia zbukuroi braktisjen e xhihadi është sprovë e madhe ku ai ra. Si

⁵ Ibnul Xheuzi, El Muntedhim (7/56).

ka mundësi pra të kërkojë shpëtimin nga një fitne e vogël pa e goditur fare, duke rënë në një sprovë të madhe, që në fakt e goditi?!

Kështu është gjendja e shumë fetarëve, që braktisin detyrën e urdhërimit në të mirë, ndalimit nga e keqja dhe xhihadit me të cilin feja do t'i takojë vetëm Allahut dhe fjala e Tij do të jetë më e larta, me arsyetimin të mos sprovohen me llojet e epshit. Ata në fakt kanë rënë në fitne edhe më të madhe seç kanë supozuar që po ikin nga ajo...”.⁶

Ibën Tejmija jo vetëm që e solli këtë parim, por ai e pasoi atë duke e vërtetuar dhe praktikuar... ai bëri xhihad në rrugë të Allahut, i largoi të këqijat, e largoi dhe e fshiu shirkun... madje i zbatoi ndëshkimet e përcaktuara (*el-hudud*) dhe ato të papërcaktuara (*et-tazir*), sa që kundër tij u çuan disa zemërligj, por ua shpjegoi gabimin, ua largoi mjegullën dhe u qetësuan e heshtën.⁷

Kur sistemi bie dhe vendi mbetet pa pushtetarë, atëherë është detyrim për secilin të çohet dhe të përmirësojë sipas mundësisë dhe të sigurojë vendin nga prishja... këtë parim e shënon Ebul Meali el Xhujeni (v. 478H), i cili thotë: “Nëse në situata jo-normale grupe të caktuara punojnë për shkundjen e aktiviteteve të atyre që synojnë prishjen, ata janë duke realizuar një ndër llojet më të rëndësishme të urdhërimit në të mirë dhe largimit nga e keqja. Kurse individët duhen ndaluar nga bartja e armëve, sepse në ato situata ka kompetentë që mbartin çështjen e muslimanëve. Pra, nëse në një situatë kur nuk ka pushtetarë, atëherë është detyrë (vaxhib) që sipas mundësisë të shpejtohet

“...Ende më i tmerrshëm është pretendimi i dikujt se ato demonstrata dhe protesta janë rebelim kundër imamit! Ku shkoi logjika e këtyre!? ...”

në largimin e pengesave ndaj besimtarëve... por nëse njerëzit nuk gjejnë askënd që mbartin çështjet e tyre është e pamundur t'i urdhërojmë të mos e bëjnë atë që kanë mundësi nga largimi i të këqijave. Nëse ata heqin dorë nga ajo që kanë mundësi, atëherë do të shtrihej prishja në vend dhe në popull”.⁸

Këto fjalë të Xhujenit janë një shembull i rëndësishëm gjatë bashkëveprimit me situata të reja, vërtetim për kuptimin e drejtë të krizave dhe ndodhive urgjente. Pasi ligji për situata të jashtëzakonshme tek qeveritë represive ka shkaktuar paralizë në jetën e përditshme dhe qëndrime negative në qëndrime dhe situata të ndryshme, përvojat-pilot dhe iniciativat praktike për të themeluar Komitete Popullore Vullnetare, dhe të tjera të ngjashme me këto, me qëllim përmirësimin e jetesës së njerëzve dhe mbrojtjes në rast krizash, me të vërtetë sollën solidaritet, bashkëpunim, bashkim dhe harmoni.

Në përfundim: Ngjarjet e Tunizisë, Egjiptit dhe Libisë zbuluan krizën e kuptimit të politikës sheriatike (*fikhu sijase sherije*) te disa vëllezër tanë selefij, ka të atillë që i hutoi shpejtësia e ngjarjeve ndaj i dhanë përparësi heshtjes dhe

⁶ El Istikame (3/287-291) shkurtimisht.

⁷ Ibën Kethir, El Bidaje (14/19,34)

⁸ Gajathul Umem fi Tejath Dhulem (fq. 386)

symbylljes, duke forcuar idenë e shikimit të gjërave negativisht, por duke i dhënë ngjyrat e qetësisë, dinjitetit dhe largimit nga mizëria dhe zhurma!

Allahu e mëshiroftë Imam Shabiun kur thotë: “Sa e mirë është mizëria: pengojnë përmbytjen e ujit, i shuajnë zjarret e mëdha dhe trazohen kundër udhëheqësve të këqij”.⁹

Ende më i tmerrshëm është pretendimi i dikujt se ato demonstrata dhe protesta janë rebelim kundër imamet! Ku shkoi logjika e këtyre!? Mos vallë u vërtetua legjitimiteti i këtyre sistemeve laike – të cilat e refuzojnë haptas sheriatin e zbritur – që sot të thuhet rebelim kundër tyre?!

Allahu qoftë i kënaqur me udhëheqësin e besimtarëve Ali ibën Ebu Talibin, që tha: “Gjithsesi njerëzit duhet të kenë udhëheqje, qoftë e mirë apo e keqe. Thanë: Të mirën e njohim, por si mendon për të keqen? Ata që së paku zbatojnë ndëshkimet e përcaktuara (el hudud), garantojnë sigurinë, luftojnë kundër armikut dhe ndajnë prenë e fituar.” – u përgjigj Aliu, *radijallahu anhu*.¹⁰

Shiko pra – Allahu të mëshiroftë – ajo udhëheqje e keqe a gjendet në Tunizi, Egjipt, Libi e të ngjashme?!

Ibën Tejmije ka thënë: “Thelbi i politikës së drejtë është plotësimi i amanetit tek ata që e meritojnë dhe gjykimi me drejtësi”.¹¹

Për sa i përket sistemeve të përmendura dhe të ngjashme me ato, si sisteme ishin të ngritura mbi tradhti, padrejtësi dhe diktaturë. Pastaj, rebelim quhet nëse bëhet me armë, ndërsa këto protesta dhe demonstrata janë larg forcës

dhe armëve, ndryshe nga ato sisteme barbare që nuk njohin metodë tjetër përveç shkatërrimit dhe represionit. Gjithashtu, ato protesta kërkojnë zbatimin e drejtësisë, plotësimin e amanetit tek ata që e meritojnë, marrjen në përgjegjësi të hajdutëve të mëdhenj... madje shumë nga këto kërkesa po realizohen – siç po vërejmë – edhe pse në këto mizëri u shkaktuan disa dëme e të këqija, dobitë janë më shumë, ndërsa sheriat ka ardhur për prurjen e dobive dhe plotësimin e tyre, ose për largimin e dëmeve dhe pakësimin e tyre.

Përgjatë historisë ngjarje të këtij lloji ka shumë, sikurse në vitin 308H kur u shtrenjtua jetesa dhe tatimet në Bagdad njerëzit u shqetësuan dhe bënë trazira... dhe vetëm atëherë u hoqën tatimet dhe zbritën çmimet.¹²

Pra, vëllezërit tanë selefij duhet të rishikojnë qëndrimet ndaj sistemeve dhe këtë duhet ta bëjnë me një studim gjithëpërfshirës zbulues, duke pasur parasysh *fikhun*, argumentin dhe njohjen e situatës e të realitetit.

Siç është droja nga represioni i pushtetarit duhet të kihet drojë edhe nga përulja para pushtetarëve, apo mbrojtja e tradhtarëve, qoftë shprehimisht apo faktikisht. Allahu qoftë në ndihmë. ■

Përshtati nga arabishtja: Omer B.

■
⁹ Dhehebi, Es Sijer 4/312.

¹⁰ Ibën Tejmije, Mexhmuul Fetava 28/297.

¹¹ Mexhmuul Fetava 28/245.

¹² Ibnul Xheuzi, El Muntedhim 13/194.

POPULLSIA MUSLIMANE E BOTËS PO DYFISHOHET

20 vite më parë bota kishte rreth 1.1 miliardë muslimanë. 20 vjet më vonë, bota do të ketë dyfishin (2.2 miliardë muslimanë)- dhe ata do të përfaqësojnë më shumë se çerekun e njerëzve në Tokë, sipas një studimi të publikuar ditët e fundit. Kjo shifër përbën një rritje me më pak se 20 për qind nga viti 1990. Pakistani do të kalojë Indonezinë, si vendi me popullsinë muslimane më të madhe në botë, teksa popullsia e tij do të kapë shifrat e 256 milionëve, parashikon “Pew Forum on Religion & Public Life”, i cituar nga CNN. Numri i muslimanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës do ta kalojë dyfishin, -thotë projekti, duke arritur në më shumë se 6.2 milionë. Popullsia e Afganistanit pothuajse do të dyfishohet, duke arritur në rreth 50.5 milionë, duke bërë që ky shtet të bëhet i nënti me popullsinë më të madhe muslimane në botë. ■

IZRAELI I TREMBET NJË “REGJIMI ISLAMIK” NË EGJIPT

Në Egjipt po rritet rreziku për vendosjen e një “regjimi islamik”, tha kryeministri izraelit, Benjamin Netanjahu. “Në këtë kohë kaosi, një grup i organizuar islamik mund të marrë në dorë shtetin”, -tha Netanjahu gjatë një konference shtypi me homologen e tij gjermane. Gjatë ditës Izraeli ka lejuar rritjen e pranisë ushtarake egjiptiane në

Sharm el-Sheik me rreth 800 ushtarë. Sipas marrëveshjes paqësore mes dy shteteve të arritur në vitin 1979, Egjipti ka pranuar krijimin e një zone të demilitarizuar në kufirin me jugun e Izraelit. /REL/ ■

JORDANI: PROTESTAT E POPULLIT NË RRUGË JAPIN REZULTAT

Nisur nga protestat e vazhdueshme Mbreti i Jordanisë Abdullah, ka shkarkuar qeverinë. Ky lajm u bë i ditur nga pallati mbretëror në Aman. Ish-këshilltari ushtarak i Monarkisë, si dhe ish-kryeministër, Maruf Al-Bakhit, do të formojë tani një kabinet qeveritar të ri. Me këtë hap shtëpia mbretërore ka reaguar ndaj kërkesës së popullit, -thuhet në një deklaratë nga pallati. Bakhit do të formojë një qeveri të re dhe është ngarkuar për realizimin “me të vërtetë të reformave”. Detyra e tij është të ndërmarrë “hapa konkretë, praktikë dhe të shpejtë”, që të gjithë jordanëzët të kenë një “jetë më të mirë dhe të sigurt”. Islamistët kanë deklaruar vazhdimisht se zgjedhjet e vitit 2007 ishin të falsifikuara. ■

OMANI NJEH SHTETIN E KOSOVËS

Mbretëria e Omanit e ka njohur shtetin e Kosovës nëpërmjet një letre zyrtare për vendosjen e marrëdhënieve diplomatike, të dërguar në ambasadën e Republikës së Kosovës në Londër. ■

KONSULLI GREK E QUAN KORÇËN “GREKE”

Me idenë e bashkimit të kombit grek, thirrje për bashkim dhe helenizim janë bërë nga Korça nga diplomatët e shtetit fqinj, në 20 vjetorin e themelimit të partisë Omonia në Korçë. Konsulli grek në Shqipëri, Theodoros Ikonomu, ka përshëndetur grekët e Korçës duke theksuar se edhe njëherë do të përsërisë të njëjtën porosi, atë se në Korçë ka grekë. Bashkë me dy deputetët grekë të Janinës dhe Follorinës, konsulli grek ka mbështetur idenë e regjistrimit të grekëve, ndërsa ka bërë thirrje për bashkim në emër të Vorioepirit. “Përshëndes grekët e Korçës sepse kjo që ndodh sot iu përket atyre. Do të jap edhe një herë të njëjtën porosi: Po, ekzistojnë grekë në Korçë. Po, vllhtë janë grekë”- u shpreh ai. ■

MUSLIMANËT KUNDËR REGJISTRIMIT: RREZIK PËR SIGURINË KOMBËTARE

Muslimanët i bëjnë thirrje Këshillit të Lartë të Drejtësisë të ndalojë veprimet abuzive, për ndërrimin e kombësisë nga grupime të caktuara. Ky reagim i Forumit Musliman vjen pas deklaratës së konsullit grek në Korçë, për regjistrimin e popullsisë. Ata i bëjnë thirrje politikanëve shqiptarë, që të mos lejojnë, që në regjistrimin e popullsisë, të vihen pyetje mbi etninë dhe fenë. “Çdo musliman i Shqipërisë i bën thirrje medieive, shoqërisë civile, grupeve të interesit, politikanëve dhe

parlamentarëve të vendosin interesat kombëtare mbi interesat personale dhe të mos lejojnë, që në regjistrimin e popullsisë të vihen pyetjet mbi etninë dhe fenë. Kjo çështje nuk është e negociueshme, në rast se politika lejon pyetësorin në formën aktuale duke shkelur me këmbë gjakun, djersën dhe mundin e të parëve tanë. Forumi Musliman i Shqipërisë i bën thirrje çdo shqiptari për bojkotimin e këtij procesi antishqiptar”, thotë Fisnik Kruja, kryetar i Forumi Musliman i Shqipërisë. Ndërkohë Forumi Musliman ka bërë publik qëndrimin e tij, duke u shprehur se regjistrimi në bazë etnie dhe feje nuk përfshihet në Rregulloren Evropiane, për regjistrimin e popullsisë. Ata i bëjnë thirrje çdo shqiptari të bojkotojë procesin e regjistrimit, ku janë të përfshira deklarami i fesë dhe i etnisë. ■

TURQIA REAGON NDAJ KISHËS NË KALA TË SHKUPIT

Ministria e Punëve të Jashtme e Turqisë përmes një deklarate ka reaguar ndaj ngjarjeve në Maqedoni, konkretisht për incidentin e muajit të kaluar në kalanë e Shkupit, në të cilin u plagosën tetë veta. Në deklaratën e bërë nga Ministria e Jashtme e Turqisë është theksuar rëndësia e mbrojtjes së trashëgimisë kulturore osmano-turke dhe veprave të tyre. Gjithashtu bëhet e ditur se ndërtimi i një kisha muze të madhe në vendin më të dukshëm të kalasë do të mund të shkaktoje një sensitivitet serioz në shoqëri. Në deklaratë theksohet, se nuk duhen dëmtuar veprat dhe ndërtesat historike, që janë trashëgimi e përbashkët e

njerëzimit. Në Ministrinë e Jashtme asnjë reagim me arsyetim nuk ka mbërritur. “Nuk mendoj që marrëdhëniet diplomatike mes Maqedonisë dhe Turqisë do të rrezikohen, për shkak të reagimit nga Ministria e Punë të Jashtme e Turqisë”, -tha zëdhënësi i Ministrisë së jashtme të Maqedonisë, Borçe Stamov. ■


GADAFI: LUFTË DERI NË NJERIUN E FUNDIT

Gjendja në kryeqytetin e Libisë, Tripoli u rëndua gjatë këtyre ditëve. Dëshmitarët i pohuan Al Xheziras, se aeroplanët e qeverisë kanë bombarduar në zona të ndryshme të Tripolit për të shtypur kështu protestat e dhunshme, të filluara që prej disa ditësh në këtë vend. Sipas tyre, vetëm nga këto sulme mendohet të jenë 250 të vrarë, në tre orë bombardime. Dy pilotë të ushtrisë, që u ulën në Maltë së bashku me avionët e tyre, u shprehën për medien ndërkombëtare, se ata u urdhëruan që të qëllonin mbi protestuesit. Më parë Organizata Human Rights Watch njoftoi se për pesë ditët e para të dhunës në Libi janë vrarë 223 persona. Përfshirja e infrastrukturës ushtarake në shtypjen e protestave rrezikon ta çojë vendin në një luftë civile. Përdorimi i aeroplanëve kundër protestuesve u mor pasi një nga djemtë e Gadafit, Seif al-Islam, në një mesazh në televizionin shtetëror u shpreh se lufta civile në Libi do ta shkatërrojë naftën e këtij vendi. Në këtë fjalim ai pranoi se protestuesit kanë marrë kontrollin ndaj disa bazave ushtarake, me armatim dhe tanke. Ai u zotua se qeveria do të luftojë kundër revoltës popullore deri “te njeriu i

fundit”, ndërsa, nga ana tjetër, premtoi dialog për reforma dhe rritje të rrogave. “Libia nuk është Egjipt. Ajo përbëhet nga fise dhe klane.” Lajmet e fundit thonë se rrethi i protestuesve e ka shtrënguar fort brenda kryeqytetit Tripoli diktatorin Gadafi.

“VËLLEZËRIT MUSLIMANË” - NË THEMELIM “PARTIA E LIRISË DHE DREJTËSISË”

Muhamed Bediu udhëheqësi i përgjithshëm shpirtëror i lëvizjes “Vëllezërit Muslimanë” theksoi se “Zyra e Udhëheqjes” ka marrë vendim, që të fillojnë përgatitjet për themelimin e një partie politike në kuadër të Lëvizjes nën emrin “Liria dhe Drejtësia”. Udhëheqësi i “Vëllezërve Muslimanë” në një deklaratë për shtyp deklaroi, se ky hap vjen në përputhje me orientimet dhe politikën e Lëvizjes të ndërmarrë nga “Këshilli i Përgjithshëm Konsultativ”, ku Këshilli në fjalë kërkoi nga Lëvizja, që të themelojë një parti politike. Ai përsëriti se themelimi i kësaj partie vjen si përgjigje ndaj kërkesave, dëshirave dhe aspiratave të popullit fisnik egjiptian për një të ardhme më të mirë dhe për një të nesërme të ndritshme, që do t’ia kthejë Egjiptit tonë të dashur rolin, pozitën dhe prestigjin e tij udhëheqës. ■



Nuk është si kusht për kënaqësinë, që njeriu të zhvishet nga ndjenjat e tij normale, si dhimbja dhe trishtimi, madje duhet pohuar se zotërinjtë e njerëzimit, qofshin profetët, të dërguarit, apo edhe njerëzit poshtë tyre i kanë kapur dhimbjet, mundimet, madje i ka përshkruar qeniet e tyre edhe trishtimi

In The Name Of GOD

JAM I KËNAQUR ME ALLAHUN SI ZOT

PROF. DR. NASIR OMER

Falënderimi i takon vetëm Allahut, paqja dhe bekimi i Allahut qofshin mbi vulën e profetëve Muhamedin *sal-lallahu alejhi ue selem*, mbi familjen e tij të nderuar, mbi shokët e tij besnikë si dhe

mbi të gjithë ata të cilët ndjekin rrugën e tyre deri në Ditën e Gjykimit. Allahu i Lartësuar thotë: ***“Thuaj: “A mos vallë do të kërkoj unë tjetër zot, përveç Allahut, kur Ai është Zoti i gjithçkaje?”***¹ Zotërimi (i Allahut) ngrihet mbi tre shtylla, kush i pranon dhe pohon ato vërtet ka pohuar

¹ Enam: 164.

dhe pranuar se Ai është Zot. Ato janë: Krijimi, Sundimi dhe Rregullimi.

Të jesh i kënaqur me Allahun si Zot është baza e hyrjes në fe dhe ajo përmbledh qenien i kënaqur me atë që ka krijuar Allahu dhe Ai është i kënaqur me të, e jo atë e cila ekziston në sajë të ndonjë urtësie, sikurse janë gjynahet. Pra, ka krijesa të cilat janë të dashura për Allahun për të cilat ka urdhëruar të kryhen apo të duhen, por ka krijesa të tjera të cilat Ai ka bërë që të ekzistojnë si shkak i urtësive, sikurse është shejtani i mallkuar, të cilin nuk e do dhe nuk është i kënaqur me të, ndaj dhe robi nuk lejohet ta dojë e të jetë i kënaqur me të. Po ashtu – ai që kënaqet me Allahun si Zot –, duhet të kënaqet edhe me sundimin e Allahut, i cili përfshin gjithçka: ***“Thuaj: “Kush është Ai që ka në dorë pushtetin mbi çdo gjë, i Cili mbron, por prej Tij nuk mund të mbrohet askush, nëse e dini?”² “Prandaj, qoftë lartësuar Ai, në Dorën e të Cilit është pushteti mbi çdo gjë! Tek Ai do të ktheheni!”³*** Besimtari është i kënaqur dhe i gëzuar me sundimin dhe pushtetin e Allahut të Lartësuar, ndaj dhe është thënë:

*Ajo që ma shton nderin dhe krenarinë
E gati më bëri me këmbë t'i shkel yjet
që ndrijnë.*

Bërja pjesë në fjalën tënde “O robërit e Mi”,

*Dhe që si profet më dërgove
Muhamedin.*

E treta: Besimtari duhet të kënaqet patjetër me rregullimin e Allahut dhe kujdesin e Tij. Ibën Rexhebi –Allahu e mëshiroftë – ka thënë: “Të qenit i kënaqur

“...Kështu që rruga e kënaqësisë dhe dashurisë e bën robin të ecë, edhe pse mund të qëndrojë i shtrirë në shtrat...”

me zotërimin e Allahut përmban kënaqjen me adhurimin e Tij të vetëm e pa-shok, si dhe kënaqja me rregullimin që Ai i bën gjërave dhe zgjedhjes që Ai bën për robin e Tij”.⁴

Që të arrish kënaqësinë e Allahut duhet të plotësosh patjetër tre kushte, të cilat i ka shpjeguar Ibën Kajim el-Xheuzije, i cili ka thënë: “Nga shkaqet më të mëdha të arritjes së kënaqësisë së Allahut është kujdesi dhe kapja pas asaj në të cilën gjendet kënaqësia e Allahut, sepse ajo që do ta shpjerë patjetër në kënaqësinë e Allahut. Një herë i thanë Jahja ibën Muadhit: Kur e arrin njeriu kënaqësinë e Allahut? Ai u përgjigj: “Nëse vepron në bazë të katër themeleve në lidhjet që ka me Zotin e tij dhe thotë: Nëse më jep e pranoj; nëse më privon sërish jam i kënaqur; nëse më lë të adhuroj dhe nëse më thërret të përgjigjem”.⁵

Padyshim që të qenit i kënaqur me Allahun si Zot ka shenjat e veta, ku njëra prej tyre është dhe mënjanimi i vrerosjes⁶, e cila është e kundërta e durimit dhe domosdoshmërisht e kënaqësisë, e cila është gradë më e lartë se ajo. Nga shenjat e kënaqësisë është edhe falënderimi i

■ 2 Muminun: 88.

3 Ja-Sin: 83.

4 Hamiu Ulum uel Hikem.

5 Medarixhu Salikin: 2/174.

6 Trishtim i tejskajshëm dhe hidhërim i madh.

vazhdueshëm e angazhimi me të, madje falënderimi shpeshherë vjen dhe me kuptimin e kënaqësisë. Shejhul Islam Ibën Tejmije – Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Kënaqësia edhe pse është nga veprat e zemrës na duhet të themi, se falënderimi është përsosmëria e saj, aq sa disa e kanë komentuar falënderimin me kënaqësinë, ndaj dhe ka ardhur në Kuran e Sunet “falënderimi i takon Allahut në çdo gjendje”.⁷ Ai që është i kënaqur me Allahun për Zot, e falënderon Atë për krijimin, sundimin dhe kujdesin (rregullimin) e Tij, si dhe është i bindur dhe larg çdo shenje pakënaqësie. Po ashtu nga shenjat e të kënaqurit me Allahun për Zot është edhe mirënjohja ndaj Tij, dhe sigurisht mirënjohja nuk mund të ekzistojë pa praninë e kënaqësisë, sikurse e ka përmendur dhe Ibën Kajimi. Të qenit i kënaqur me Allahun për Zot vërtetohet në bazë të tre kushteve:

Që Allahu i Lartësuar të jetë për robin më i dashur se çdo gjë tjetër.

T’i japë përparësi madhërimit të Tij ndaj çdo gjëje.

Të jetë më i denji nga çdo gjë tjetër për t’iu bindur.

Që Allahu i Lartësuar të jetë për robin më i dashur se çdo gjë tjetër ka nevojë që të përkufizohet me tre gjëra:

E para: Që dashuria e Allahut t’i paraprijë në zemrën e robit çdo dashurie, pra që dashuri e Tij të jetë parësore ndaj dashurisë së çdokujt.

E dyta: Që të munda dashuria e Tij çdo dashuri tjetër, kështu që dashuria e tij në zemër duhet të jetë në rend të parë dhe ngadhënjimtare, ndërsa dashuria për të tjerët të vijë pas dashurisë së Tij dhe të jetë e mposhtur prej saj dhe e mbështjellë

në dashurinë e Tij.

E treta: Dashuria e çdokujt tjetër të jetë në rend pas dashurisë së Allahut, kështu që Allahu është i dashur në qenien e Tij, ndërsa të tjerët duhen për shkak të dashurisë së Tij, sikurse u binden si shkak ligjërit të Tij,⁸ ndaj në realitet Ai është që i binden me dashuri. Këto të tre janë të njëjta edhe për madhërimin dhe për bindjen.

Konkluzioni i kësaj është se: Allahu është i vetmi, i cili e meriton dashurinë, madhërimin dhe bindjen absolute, ndaj dhe ai i cili nuk e do, nuk e madhëron dhe nuk i bindet tregohet kryeneç ndaj Tij. Por nëse dikë e do, e madhëron dhe i bindet në mënyrë të barabartë me Allahun, atëherë ai konsiderohet idhujtar. Në momentin që rob i veçon Allahun dhe nuk i shoqëron askënd në dashuri, madhërim dhe bindje, atëherë ai konsiderohet si njësuës.

Nuk është si kusht për kënaqësinë, që njeriu të zhvishet nga ndjenjat e tij normale, si dhimbja dhe trishtimi, madje duhet pohuar se zotërinjtë e njerëzimit, qofshin profetët, të dërguarit, apo edhe njerëzit poshtë tyre i kanë kapur dhimbjet, mundimet, madje i ka përshkruar qeniet e tyre edhe trishtimi. Dhe kjo pyetje vjen shpesh në lidhje me kënaqjen ndaj asaj që ka caktuar Allahu, e cila është nga përsosmëria e të qenit i kënaqur me Allahun si Zot. Pra, sikurse e pohuam edhe më parë të kënaqurit me Allahun si zot, është një detyrim pa të cilin besimi nuk mund të ekzistojë, dhe nga përsosmëria e tij është të kënaqurit me atë që ka caktuar Allahu i Lartësuar. Dhe kjo sigurisht që nuk bie ndesh me atë që sapo cituam më lart, dhe falënderimi i takon Allahut.

⁷ Tuhfetul Irakije.

⁸ Se Allahu ka urdhëruar të pasohen.

Ibën Kajimi –Allahu e mëshiroftë- ka thënë: “Nuk është kusht e të qenit i kënaqur, që të mos ndiesh dhimbje, apo vuajtje. Jo, por kusht është të mos kundërshtosh gjykimin e Allahut dhe të mos shprehësh pakënaqësi ndaj tij. Ndaj dhe kjo shkaktoi paqartësi tek disa njerëz, të cilët nuk arritën të perceptonin qenien e besimtarit të kënaqur edhe kur goditet me fatkeqësi. Ata u shprehën, se kjo është e pamundur për natyrën e njeriut, ndaj dhe këtu kemi të bëjmë me durimin,⁹ sepse si mund të bashkohen tek dikush të kënaqurit ndaj diçkaje dhe urrejtja e saj, ndërkohë që ato janë dy të kundërta? Por e vërteta është, se nuk ka përplasje mes këtyre të dyjave dhe se prezenca e dhimbjes dhe mos shprehja e pëlqimit të vetes, nuk bie ndesh me kënaqësinë. Si kënaqësia që ndjen i sëmuri, i cili pi një ilaç të hidhur, si kënaqësia e agjëruesit në një ditë tejet të nxehtë edhe pas urisë e etjes që e kaplon, apo si kënaqësia e luftëtarit, i cili arrin në luftën për Allahun dhimbjen e plagëve etj”.

Rruga e kënaqësisë është një rrugë e shkurtër dhe e afërt. Ajo të çon drejt qëllimit më të lartë, megjithatë sigurisht në të ka vështirësi, por asnjëherë kjo vështirësi nuk është më e rëndë, sesa vështirësia e përpjekjes, madje nuk ka në të aq pengesa sa gjenden në të dytën. Pengesa e saj është ambicia e lartë, shpirti i çiltër dhe stabiliteti i vetes në ato të cilat i vijnë prej Allahut. E ndihmon njeriun për këtë vetëdija për dobësinë dhe pamundësinë që e shoqëron atë, si dhe vetëdija për mëshirën e Allahut, dhembshuria dhe bamirësia ndaj tij. Nëse ai i ka parasysh të dyja këto dhe nuk e flak

veten para Allahut, duke u kënaqur me Të dhe ndaj Tij, si dhe duke kërkuar rrugët e dashurisë dhe kënaqësisë së Tij, atëherë shpirti i këtij (robi) do të jetë larg Allahut dhe i hedhur tej, nuk është i denjë të jetë afër Tij e aq më shumë të jetë mik i Tij, sikurse nuk është e denjë për t’u sprovuar, me sprova dhe mundime të ndryshme!

Kështu që rruga e kënaqësisë dhe dashurisë e bën robin të ecë, edhe pse mund të qëndrojë i shtrirë në shtrat, duke paraprirë karvanin e duke qenë shumë përpara tyre! Dhe nga frytet e kënaqësisë është hareja dhe gëzimi, që ndien njeriu ndaj Allahut të Lartësuar, dhe e kam parë Shejhul Islam ibën Tejmijen në ëndërr, sikur po e pyesja për një nga veprat e zemrës, duke përmendur vlerësimet dhe përfitimet e saj, të cilat tani nuk më kujtohen, ndërsa ai më tha: “Ndërsa rruga ime është ndjenja e haresë dhe gëzimit me Allahun”, apo diçka të ngjashme. E tillë ka qenë gjendja e tij në këtë jetë, dukej qartë në aparencën e tij dhe thërriste me të gjendja e tij”.¹⁰ ■

Përshtati: Bledar Tefik Haxhiu

■
⁹ Duket sikur ata thonë: nuk themi se njeriu është i kënaqur me caktimin e Allahut, porse tregohet durimtar ndaj caktimit të Allahut. (sh.p).

¹⁰ Medarixhu Salikin, Ibën Kajim Xheuzije: 2/175-176.

TREGIMI I KATËR GRAVE

SHKRUAN: BESNIK ABRASHI

Na ishte një herë një tregtar i pasur, i cili kishte katër gra. Ai e donte gruan e katërt më shumë dhe e kishte zbukuruar atë me rroba të pasura dhe e trajtonte atë me butësi. Ai kujdesej shumë për të dhe nuk i dhuronte pëveçse gjërat më të mira. Ai gjithashtu e donte gruan e tij të tretë. Ai është shumë krenar me të dhe gjithmonë dëshironte ta nxirrte në publik para shokëve të tij. Sidoqoftë tregtari gjithmonë frikësohej, se ajo mund të ikte me ndonjë burrë tjetër. Ai po ashtu, e donte gruan e tij të dytë. Ajo është me të vërtetë një person i kujdesshëm, gjithmonë e durueshme dhe në të vërtetë është shoqja e ngushtë e tregtarit. Sa herë që tregtari përballet me probleme, ai gjithmonë kthehet tek gruaja e tij e dytë dhe ajo gjithmonë do ta ndihmojë atë dhe do ta përcjellë atë në kohët e vështira. Tani, gruaja e parë e tregtarit është një partner shumë besnik dhe ka dhënë kontribute të mëdha në mirëmbajtjen e pasurisë dhe biznesit të tij, si dhe në kryerjen e punëve të shtëpisë. Sidoqoftë, tregtari nuk e donte gruan e parë dhe megjithëse ajo e donte shumë atë, ai mezi

që e vërente atë.

Një ditë prej ditësh, tregtari u ndje i sëmurë. Nuk shkoi shumë gjatë dhe ai mësoi se do të vdiste së shpejti. Ai mendoi për jetën e tij luksoze dhe i tha vetvetes, *“Tani kam katër gra për vete. Por kur të vdes do të jem vetëm. Sa i vetmuar do të ndjehem!”* Kështu që ai e pyeti gruan e katërt: *“Unë të kam dashur ty më shumë, të kam pajisur me veshjet më të mira dhe jam kujdesur shumë për ty. Tani që po vdes, a do të vish me mua dhe të më bësh shoqëri?”* **“S’ka shans!”** u përgjigj gruaja e katërt dhe u largua prej aty pa thënë ndonjë fjalë tjetër. Përgjigjja e goditi si një thikë e mprehtë drejt e në zemrën e tregtarit. Tregtari i mërzhitur pastaj pyeti gruan e tretë: *“Unë të kam dashur ty aq shumë gjatë gjithë jetës sime. Tani që po vdes, a do të vish me mua e të më bësh shoqëri?”* **“Jo!”** - u përgjigj gruaja e tretë. **“Jeta është shumë e mirë këtu! Unë do të martohem përsëri kur ti të vdesësh!”** Zemra e tregtarit u mbyt dhe u ftoh krejt. Ai pastaj e pyeti gruan e dytë: *“Unë gjithmonë jam kthyer tek ti për ndihmë dhe gjithmonë më ke ndihmuar. Tani kam nevojë përsëri për ndihmën tënde. Kur unë të vdes, a do të vish me mua e të më bësh shoqëri?”* - **“Më vjen keq, nuk mund të të**



ndihmoj kësaj here, - u përgjigj gruaja e dytë. **“Më e shumta që mund të bëj, është të të dërgoj deri te varrezat.”** Përgjigja i ra si një goditje vetëtime dhe tregtari u shkretua.

Pastaj u dëgjua një zë : **“Unë do të jetoj me ty. Do të vij me ty pa marrë parasysh se ku shkon.”** Tregtari e ngriti shikimin dhe aty ishte gruaja e tij e parë. Ajo ishte aq e dobët, sa dukej sikur kishte vuajtur nga mosushqimi. Shumë i pikëlluar tregtari i tha: **“Unë do të duhej të kujdesesha për ty më shumë, kur kisha mundësi!”**

Morali

Në të vërtetë ne të gjithë kemi katër gra në jetët tona:

a. Gruaja e katërt është trupi ynë. S’ka rëndësi se sa shumë kohë dhe përpjekje shpenzojmë që të duket i bukur, ai do të na braktisë kur ne të vdesim.


b. Gruaja jonë e tretë? Malli jonë, statusi dhe pasuria. Kur ne të vdesim të gjitha ato shkojnë tek të tjerët.

c. Gruaja jonë e dytë janë familja dhe shokët. S’ka rëndësi sa të afërt kanë qenë me ne kur ishim të gjallë, më e shumta që mund të vijnë me ne është deri tek varri.

d. Gruaja e parë në të vërtetë është shpirti ynë, shpesh i neglizhuar në kërkim të kënaqësisë materiale, pasurore dhe sensuale.

Qëllojani çfarë? Në të vërtetë është e vetmja gjë që vjen me ne kudo që të shkojmë. Ndoshta është ide e mirë ta kultivojmë dhe ta forcojmë atë tani se sa të presim derisa të shtrihemi në shtratin tonë të vdekjes duke vajtuar. ■

televizioni I TEJ KALONJË PULLAT E KUQË



LULUA THANI

Si mund ta mbrojmë veten nga transmetimet e dëmshme satelitore? Këto janë tri pyetje që i shtrojnë tri vajza që përfaqësojnë “Qendrën e Fëmijëve dhe Vajzave” në qytetin e Sharikas në Emiratet e Bashkuara Arabe. Xhenan Muhamed, Naime Kabi dhe Esma Ubejdili marrin pjesë në një ligjëratë të organizuar posaçërisht për të tërhequr vërejtjen ndaj rrezikut të madh, që përfaqësojnë

programet dhe telenovelat televizive, të cilat hedhin helmin në mjaltë dhe që përplasën për muri shumë nga vlerat edukative, zakonet dhe traditat e mira.

Sihru Ali, koordinatori dhe qendër “Butësia” në Sharika bën me dije, se kjo qendër ka organizuar ligjëratat, të cilat synojnë tërheqjen e vërejtjes ndaj përgjegjësve dhe organizatorëve përzgjedhës të programeve televizive, sepse të tilla programe dhe fragmente janë një amanet që u varet në qafë dhe duhet që të serviren sipas normave pozitive që

mbizotërojnë, sidomos kur disa kanale satelitore shfaqin materiale filmike, që përcjellin mesazhe mediatike të prishura, të cilat i tejkalojnë pullat e kuqe dhe që janë të zhveshura nga mesazhi i tyre human, e jo më nga mesazhi edukativ.

Ajo bën me dije se të tilla ligjërata i bëjnë thirrje prindërve, që të tregohen të kujdesshëm që t'ua mbushin kohën fëmijëve të tyre, sidomos në këtë moshë tepër delikate me gjithçka është e dobishme për të ndërtuar personalitetin e tyre në të ardhmen, dhe që të marrin pjesë me efikasitet në ndërtimin e shoqërive të tyre.

Revolucioni i informatikës

Në fillim të bisedës së saj Xhenan Muhamedi foli për programet televizive që bien ndesh me edukatën dhe fenë, të cilat janë “vepra arti të kalbura”, dhe prej të cilëve duhet të shpëtojmë menjëherë, duke parë ndikimin e tyre të rrezikshëm dhe të drejtpërdrejtë te moshat e njoma, të cilat po përballen me një revolucion të informatikës, i cili përmban në vetvete një lumë të madh të dhënash në të cilat përzihet shapi me sheqerin, e mira me të keqen, ku fëmija natyrisht e ka të pamundur që të bëjë dallimin mes asaj që është e gabuar dhe asaj që është e saktë. Për këtë arsye prindërit dhe kujdestarët e fëmijëve luajnë një rol të rëndësishëm duke kontrolluar që në fillim të gjitha materialet televizive, të cilat janë të lejuara dhe që i përshtaten të gjitha moshave. Më tej ajo vazhdon: “Rreziqet e programeve të këqija satelitore i ftojnë njerëzit që t’u përngjajnë njerëzve me sjellje, jetesë, veshje dhe zakone jo të shëndosha, sidomos ata që quhen “newlook”, përkrah paraqitjes së marrëdhënieve të ndaluara, prishjes së normave të moralit dhe grisjes së turpit

“Kur fëmija shikon programe të këqija, korrigjimi i të cilave në asnjë rast nuk duhet të bëhet nëpërmjet goditjes apo ashpërsisë, sepse rezultati do të jetë i kundërt...”

dhe programeve që paraqesin krime, dhunë dhe mënyra të ndryshme krimi në një formë tepër tërheqëse që të nxit ta imitosh. Përveç kësaj, këto programe të nxisin që të shpërdorosh kohën e shtrenjtë në gjëra, që në pjesën më të madhe të sjellin vetëm dëm dhe që ndikojnë negativisht në marrëdhëniet mes pjesëtarëve të së njëjtës familje, duke i larguar ata nga njëri-tjetri përmes shikimit të televizorit në vend të bisedave familjare. Gjithashtu këto programe ndikojnë negativisht në shikimin dhe në shtrembërimin e trupit për shkak të qëndrimit të gjatë ulur. Ajo shton se transmetimet satelitore të shpeshta dhe që i kalojnë kufijtë gjeografikë përcjellin botëkuptime, të cilat mund të përmbysin shumë vlera. Të gjithë studiuesit janë në një mendje për domosdoshmërinë e mbrojtjes së fëmijës nga transmetimet satelitore, të cilët cenojnë vlerat edukative dhe ndihmojnë në praktikimin dhe përhapjen e sjelljeve perverse dhe të papranueshme.

Ajo nënvizon faktin, se një përgjegjësi të madhe ka familja për mbrojtjen e fëmijëve, duke i ndjekur ata vazhdimisht me pjesëmarrjen e më të mëdhenjve bashkë me të vegjlit në ndjekjen e programeve satelitore dhe duke e shoqëruar këtë me komente të

vazhdueshme rreth gabimeve që transmetohen, kur fëmija shikon programe të këqija, korrigjimi i të cilave në asnjë rast nuk duhet të bëhet nëpërmjet goditjes apo ashpërsisë, sepse rezultati do të jetë i kundërt, kur fëmija do t'i sfidojë urdhrat dhe do të gjejë rastin për t'i parë të gjitha pjesët filmike për të cilat është goditur më parë.” Ajo shfaq keqardhjen e saj për gjendjen e shumë shoqërive arabe dhe muslimane në të gjithë botën, ku transmetimi satelitor ka ndikuar për keq në humbjen dhe në prishjen e imazhit, duke i bërë këto shoqëri që të humbin një pjesë të karakteristikave të tyre me të cilat janë dalluar përpara se të largoheshin nga tradita dhe të ndiqnin rrjedhën e modernizimit, të modës së çmendur dhe të asaj ane të errët të zhvillimit, në vend që të përfitonin nga anët e ndriçuara të tij në shërbim të zhvillimit të institucioneve dhe sektorëve të ndryshëm në vend dhe në shërbim të ndriçimit të mendjeve. Në realitet këto shoqëri garuan në përthithjen e shumë programeve, të cilat zgjasin me javë dhe me muaj të tërë siç janë telenovelat meksikane të dubluara, që na përcjellin detaje të frikshme të disa veprimeve që i bëjnë njerëzit nëpërmjet kamerave të montuara në çdo cep të shtëpisë ku ata qëndrojnë (*Big brother*).

Artistë dhe këngëtarë

Ajo pyet duke hedhur poshtë këtë format edukimi: Çfarë kanë përfituar vajzat e moshës sime nga ndjekja e këtyre programeve, duke rendur pas artistëve dhe këngëtarëve për të njohur në detaje menynë e tyre të ushqimit që preferojnë, apo llojet e kafshëve të buta që mbajnë në shtëpitë e tyre, apo vendet në të cilat shkojnë dhe i preferojnë? Në të njëjtën kohë, ne kemi shumë nevojë për një shembull të mirë dhe për ndjekjen e

“...Materialet televizive kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen tonë dhe në mënyrën se si i shikojmë gjërat përreth nesh...”

gjurmëve të njerëzve vepërmirë dhe të tabi'inëve, në adhurim dhe në vepra të mira dhe në të gjitha anët e ndryshme të jetës.

Programe qëllimplota

Esma Ubejdi flet për rëndësinë e përzgjedhjes së materialeve, që shohim në ekranet e televizorit, ashtu siç kujdesemi për të përzgjedhur atë që hamë apo veshim, sepse programet që preferon të ndjekësh reflektojnë natyrën e preferencave dhe shijes tënde, e mirë apo e keqe qoftë. Edhe nëse nuk e beson këtë që po them, është e më se e vërtetë se materialet televizive kanë ndikim të drejtpërdrejtë në sjelljen tonë dhe në mënyrën se si i shikojmë gjërat përreth nesh. Për këtë arsye njeriu duhet të kërkojë ato mjete moderne, të cilat i sjellin dobi dhe jo dëm. Esmaja tregon se shikimi i televizorit është vetëm një pjesë e programit të saj të mbushur me përsëritjen e mësimëve, jo siç veprojnë shumë njerëz, të cilët e kthejnë shikimin e televizorit në një qëllim më vete, sidomos kur bëhet fjalë për materiale të pamoralshme.

Këtë mendim ka edhe Naime Kabi, se transmetimet satelitore janë një mjet për të shtuar kulturën dhe ndonjëherë edhe për t'u argëtuar siç janë filmat tërheqës vizatimorë, ndërkohë që disa të tjerë

kujdesen që të ndjekim lajmet më të fundit të filan aktoreje deri në detaje. Madje nuk mjaftohen me kaq, por ndjekin të gjitha thashethemet për artistet e tyre të preferuara përmes internetit. Mendoj se të tilla objektiva jo vetëm që na humbin kohën, por edhe energjitë.

Këshilla dhe përfundime

Naimja përmendi në këtë ligjëratë dhe tërhoqi vërejtjen ndaj ndëshkimit të Allahut në këtë botë dhe në tjetrën dhe bëri thirrje për shfrytëzimin e kohës në punë të mira, në mënyrë që njeriu të mos gjejë kohë për shikimin e programeve televizive të prishura dhe këngëve të ndyra. Gjithashtu ajo bëri thirrje për më shumë përpjekje në furnizimin e fëmijëve me materiale filmike islame, që janë tërheqëse dhe domethënëse, të cilat flasin për mrekullitë e profetëve dhe për historitë e tyre të bukura. Gjithashtu duhet që fëmijëve t'u bëhen të ditura të gjithë rreziqet e kanaleve satelitore përmes libërthave dhe fletëpalosjeve, duke ua bërë me dije të gjitha ato kanale që përcjellin programe të dobishme, apo duke ua fshirë të gjitha ato kanale, që përcjellin materiale jo të dobishme.

Hibe Basim bën me dije se aparatet televizive kanë sulmuar shtëpitë tona në mënyrë tepër të dukshme, aq shumë sa nuk ka shtëpi, ku të mos ketë më shumë se një televizor dhe ku familja mblidhet për të ngrënë apo për të biseduar në prezencë të tij (televizorit), derisa më në fund ai arrin që të mbizotërojë mendjet tona përmes programeve të tij, të cilat synojnë posaçërisht një grupmoshë tepër të rëndësishme të shoqërisë, që janë të rinjtë dhe fëmijët, të cilët i ndjekin këto programe edhe nëse ka dëm për akiden e tyre, apo edhe kur luhet me logjikën e tyre. Madje shpeshherë edhe kur këto

“...Aparatet televizive kanë sulmuar shtëpitë tona në mënyrë tepër të dukshme, aq shumë sa nuk ka shtëpi, ku të mos ketë më shumë se një televizor ...”

programe dalin jashtë kornizës së turpit. Ajo na paraqet disa të dhëna në këtë fushë. Kështu, më shumë se 85% e familjeve shikojnë kanale që shfaqin pamje të shthurura, 53% e tyre kanë lënë pas dore shumë detyrime fetare, për shkak të angazhimit me shikimin e kanaleve televizive, 32% e tyre kanë pësuar pakësim të përthithjes së mësimave shkollorë, për shkak të ndjekjes së programeve në vend të përkujdesjes me mësimet dhe 42% e familjeve preferojnë martesën e hershme, për shkak të skenave që shikojnë në këto kanale.

Si përfundim, televizori është një thikë me dy tehe, e cila është e domosdoshme që të përdoret, por me kusht që të jemi në gjendje ta orientojmë atë në shërbim të vetes, atdheut dhe fesë sonë, e cila na bën thirrje, që ta respektojmë mendjen dhe ta përdorim mjetin në dobinë tonë.■

Nga arabishtja: Genc PLUMBI

ADOPTIMI I FËMIJËVE

Në këtë shkrim do ti bëjmë një vështrim kësaj praktike nga aspekti islam, që të shohim se çfarë qëndrimi mban jurisprudenca islame ndaj kësaj problematike dhe cilat kritere duhet të kihen parasysh, nga ana e atyre çifteve që dëshirojnë të rrisin ndonjë fëmijë tjetër, nga pamundësia që ata të kenë fëmijën e tyre.

SHKRUAN: ALAUDIN ABAZI

Dëshira për të pasur fëmijë dhe lënia e pasardhësve është një prirje e vetvetishme e krijuar te njeriu që daton prej ekzistimit të tij në këtë botë. Për këtë edhe orvatjet e njerëzimit që t'i tejkalojnë pengesat të cilat u pamundësojnë bashkëshortëve për të pasur fëmijë janë të shumta. Përderisa në të kaluarën edhe shkaqet më të vogla kanë qenë pengesë për mospasjen e fëmijëve nga ana e çifteve, fatmirësisht në kohën bashkëkohore, me përparimin e mjekësisë, është arritur një progres i jashtëzakonshëm në këtë fushë.

Megjithëkëtë, çështja e mospasjes së pasardhësve, prapë mbetet problem për disa çifte, posaçërisht, ata të cilët vuajnë nga komplikimet të cilat mjekësia nuk ka arritur t'i evitojë. Prandaj, edhe ky është njëri nga shkaqet më të theksuara që i bënë njerëzit të kërkojnë alternativat të cilat sadopak do ta zëvendësojnë këtë instinkt njerëzor. Alternativa më e njohur është adoptimi i fëmijëve, një veprim të cilin e kanë praktikuar pothuajse të gjitha shoqëritë njerëzore, edhe pse tek ata ka dallime në disa aspekte.



Në këtë shkrim do ti bëjmë një vështrim kësaj praktike nga aspekti islam, që të shohim se çfarë qëndrimi mban jurisprudenca islame ndaj kësaj problematike dhe cilat kritere duhet të kihen parasysh, nga ana e atyre çifteve që dëshirojnë të rrisin ndonjë fëmijë tjetër, nga pamundësia që ata të kenë fëmijën e tyre.

Çfarë është për qëllim me adoptim.

Adoptimi ose birësimi, është një praktikë mjaft e përhapur në shoqëritë njerëzore dhe nënkupton që familja ta marrë një fëmijë të mitur të tjetërkujt dhe duke ia dhënë të drejtat e njëjta si të fëmijës së barkut, ta bëjnë atë bir respektivisht bijë të tyre. Këtu nënkuptohet edhe ndjekja e procedurave ligjore e zyrtare që e ligjësojnë këtë adoptim. Prandaj edhe shumë shtete nëpër vende të ndryshme parashohin ligje në lidhje me adoptimin e fëmijëve.

Adoptimi para shpalljes së Islamit

Adoptimi ishte mjaft i përhapur edhe në mesin e arabëve para shpalljes së Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të. Arsyet për këtë praktikë ishin varfëria e pamundësia që fëmija të rritet në familjen e prindërve të vërtet, përkujdesja ndaj fëmijëve të braktisur, pamundësia e çifteve që të kenë fëmijë, etj. Gjithashtu shkak për të adoptuar fëmijë ishte edhe dëshira që fëmija t'i bashkëngjitet trungut gjenealogjik të "prindit adoptues" i cili ka pozitë dhe respekt të madh në shoqëri, ose kur ndonjërit prej njerëzve i pëlqente fuqia apo trimëria e ndonjë fëmije, ai e adaptonte atë duke e konsideruar si një nga fëmijët e tij dhe ai e fitonte të drejtën e trashëgimisë sikur që kishin fëmijët e tjerë.

Edhe vetë Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, e kishte adoptuar Zejd ibën Harithen dhe kjo kishte ndodhur para se të shpallej ndalesa nga ana e Allahut të

“...Prejardhja nuk është diçka që njerëzit e vendosin se kush i kujt duhet të jetë dhe me marrëveshje t'i përcaktohen prindërit njeriut...”

Madhërishëm në Kuranin fisnik.

Zejd ibën Harithe ishte një djalë arab nga rrethinat e Shamit i cili që në fëmijëri u rrëmbye padrejtësisht e u robërua dhe u shit në tregun e robërve. Atë e bleu Hakim ibën Huzami dhe ky ia dhuroi hallës së tij Hatixhes. Hatixheja ishte gruaja e parë e Profetit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, e cila u martua me të, para shpalljes së Islamit. Hatixheja pas martesë ia dhuroi Zejdin, Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të.

Me një rast, derisa Zejdi ishte në treg, një grup nga fisi i tij e panë dhe e njohën se ky ishte një nga fisi i tyre. Ata shkuan te babai i Zejdit dhe xhaxhallarët e tij dhe i treguan se e kanë gjetur djalin që po e kërkojnë prej kohësh. Pasi kuptoi familja se Zejdi ishte në Mekë, shkuan atje dhe duke pyetur e gjetën shtëpinë e të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të. Ata ia rrëfyer ngjarjen se si Zejdi nuk ishte rob, por ishte rrëmbyer nga familja dhe ishte shitur si rob. Babai i Zejdit kërkoj nga Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, që t'ia kthejë djalin e tij dhe nëse është nevoja edhe të paguajë. I Dërguari, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, u tha se Zejdi do të jetë i lirë, nëse ju zgjedh juve, atëherë mund ta merrni prapa, pa asnjë kompensim, por nëse më zgjedh mua, atëherë nuk do t'ua dorëzoj. Ashtu edhe veproi, kur erdhi Zejdi, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, i dha mundësinë e zgjedhjes dhe Zejdi tha: **“Për**

Zotin nuk do ta zgjidhja askënd, para të Dërguarit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të”, dhe refuzoi të kthehet në Sham.

Pas kësaj, Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, e liroi Zejdin nga robëria, e adoptoi dhe e shpalli për djalë të vetin duke u thënë Mekasëve: *“O fisi i Kurejshit dëshmoni se ky është biri im dhe ky do të më trashëgojë mua e unë do të trashëgoj atë”*. Që nga kjo kohë Zejdi thirrej Zejd ibën Muhamed (Zejdi djali i Muhamedit).

Pra, ky adoptim ndodhi gjatë kohës kur Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, ishte shpallur profet dhe e komunikonte shpalljen, prandaj duhet ta dimë se tradita e adoptimit të fëmijëve, sikurse edhe shumë tradita të tjera nuk u ndaluan përnjëherë, në fillim të Islamit, por gradualisht, ashtu sikurse pirja e alkoolit, kamata dhe disa dukuri negative të kohës së injorancës. Kështu më vonë kur Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, migroi në qytetin e Medinës, zbritën citatet kuranore që ndalojnë adoptimin e fëmijëve.

Ndërsa me ajetin 40 të sures Ahzab në mënyrë eksplicite i ndalohet Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, adoptimi i fëmijëve. Allahu i Madhërishtëm thotë:

“Muhamedi nuk është baba i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i

...Nuk ka asnjë person që pretendon se është i biri i një prindi, që në realitet nuk është dhe ai e di këtë, e që nuk ka bërë kufër...”

Gjithëdhjshëm për çdo gjë.”¹

Që do të thotë se Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, nuk është babai i vërtetë i asnjërit nga burrat tuaj, e as që është babai i Zejdit.

Pas kësaj njerëzit filluan ta thirrin Zejdi biri i Harithes pasi që kështu ishte emri i babai të tij të vërtetë, e jo Zejdi biri i Muhammedit siç thirrej më pare.²

Motivi mbi të cilin bazohet dispozita islame rreth adoptimit

Para se të flasim rreth dispozitave islame në lidhje me adoptimin e fëmijëve duhet të sqarojmë se një nga objektivat më thelbësore në bazë të së cilës janë ngritur një numër i konsiderueshëm i ligjeve në jurisprudencën islame është ruajtja e nderit dhe e pasardhësve të njeriut (*Hifdhul Irdi uen Nesli*). Madje kjo është njëra nga pesë domosdoshmëritë e përgjithshme të sheriatit (*Ed Darurijat el Hams*) mbi të cilat ndërtohen dispozitat Islame.³

përkitazi me luftën (xhihadin), ritet e adhurimit (ibadetet), etj., të gjitha këto janë vënë për ruajtjen e Fesë. Ligjet në lidhje me ndëshkimet, dëmshpërblimet, ndalimi i vrasjes, etj., janë vënë për ta ruajtur jetën e njeriut. Ndalimi i konsumimit të alkoolit, narkotikëve, etj., synojnë ruajtjen e mendjes. Ndalimi i marrëdhënieve seksuale joligjore (amoraliteti), çështjet e trashëgimisë dhe ligjet e ngjashme, janë vënë për ta ruajtur nderin dhe prejardhjen. Ndëshkimet për vjedhje, kriteret e fitimit të pasurisë hallall, janë vënë për ta ruajtur pasurinë. “El Muvafekat”, Shatibiu, vëll. 1, f. 38.

¹ Suretu Ahzab, 40.

² “Tefsir Ibën Kethir”, vëll. III, f. 615.

³ Dobitë e përgjithshme të cilat i synon sheriatit t'i realizojë nëpërmjet vënies së ligjeve, përmblidhen në pesë interesa. Këto në terminologjinë e sheriatit quhen: “Ed Darurijat el Hams”-“Pesë Domosdoshmëritë e Sheriatit” dhe ato janë:

1. Ruajtja e fesë (hifdhu din);
2. Ruajtja e jetës së individit (hifdhun nefsi);
3. Ruajtja e mendjes (hifdhul akël),
4. Ruajtja e nderit dhe pasardhësve (hifdhun nesli)
5. Ruajtja e pasurisë (hifdhul mal). Prandaj ligjet

Nuk ka dyshim se çështja e adoptimit të fëmijës bënë pjesë në objektivin e ruajtjes së pasardhësve, prandaj edhe vështrimi i Islamit në lidhje me ndryshimin e identitetit të fëmijës, duke ia ndërruar prejardhjen, origjinën dhe prindërit, konsiderohet e ndaluar pasi që cenon të drejtat individuale të çdo njeriu dhe shtrembëron të vërtetën.

Njeriu në jetë në lidhje me vetën e tij mund të ndryshojë shumë gjëra, mirëpo janë disa të tjera në të cilat nuk ka mundësi të ndërhyjë, edhe nëse e shpenzon tërë pasurinë e botës. Ndër këto pak gjëra është ndërrimi i prindërve dhe i prejardhjes së tij.

Fakti se njerëzit e bëjnë këtë dhe i ndryshojnë prindërit e fëmijëve duke i quajtur ata se janë bij dhe bija të filanit dhe tjetrit, bile edhe duke ua ndërruar emrat e prindërve të vërtet me ata të adaptuar edhe në letrat zyrtare, kjo nuk e bënë këtë veprim të përligjur. Prejardhja nuk është diçka që njerëzit e vendosin se kush i kujt duhet të jetë dhe me marrëveshje t'i përcaktohen prindërit njeriut, ose njeriu me dëshirën e tij të përzgjedhë se kush duhet të jetë babai e nëna e tij dhe kush jo. Nga këndvështrimi Islam kjo nuk i është lënë në të drejtën e njerëzve që të manovrojnë me prejardhjet e fëmijëve të mitur, e as në të drejtën e fëmijëve (pasardhësve), kurdo që kanë dëshirë t'i ndërrojnë prindërit e tyre.

Argumentet të cilat ndalojnë adoptimin e fëmijëve:

Ashtu si kuptuam më herët, kjo çështje në fillim të Islamit ishte e lejuar, mirëpo pasi që periudha e zbritjes së Islamit vazhdoi 23 vite me kalimin e kohës dhe duke u plotësuar legjislatura islame, u ndalua edhe kjo praktikë. Ndërsa argumentet të cilat ndalojnë adoptimin e fëmijëve në Islam gjenden në Kuran dhe në hadithe të

“...Me adoptim i bëhet padrejtësi prindërve të vërtetë dhe njëkohësisht i nëpërkëmbet nderi njerëzor dhe të drejtat e tij si prindër...”

Muhamedit, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, ndër këto citate veçojmë:

Allahu i Madhërishëm thotë: *“...E as fëmijët tuaj të adoptuar nuk i konsideron si bij të vërtetë. Këto janë vetëm fjalë që dalin prej gojës suaj, kurse Allahu thotë të vërtetën dhe udhëzon në rrugë të drejtë. Thërritni të adoptuarit sipas etërve të tyre! Kjo është më e drejtë tek Allahu. Në qoftë se nuk e dini emrin e etërve të tyre, konsiderojini ata si vëllezërit tuaj të besimit dhe si të mitur nën kujdesin tuaj. Nuk është gjynah nëse gaboni, por është gjynah, kur zemrat tuaja bëjnë faj me qëllim. Allahu është Falës dhe Mëshirëplotë.”*⁴

Gjithashtu thotë: *“Muhamedi nuk është baba i askujt prej burrave tuaj, por është i Dërguari i Allahut dhe vula e profetëve; Allahu është i Gjithëdijshtëm për çdo gjë.”*⁵

Muhamedi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të ka thënë: *“Kush pretendon se është i biri i një prindi, kurse ai në të vërtetë nuk është dhe në këtë është i vetëdijshtëm, xheneti është i ndaluar për të.”*⁶

Gjithashtu ka thënë: *“Nuk ka asnjë person që pretendon se është i biri i një prindi, që në realitet nuk është dhe ai e di këtë, e që nuk ka bërë kufër. Kush pretendon se i takon një fisi që në realitet*

⁴ Suretu Ahzab, 4-5.

⁵ Suretu Ahzab, 40.

⁶ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

nuk ka me ta origjinë, le ta përgatisë karrigen nga zjarri.”⁷

Arsyet e ndalimit të adoptimit të fëmijës në Islam:

Islami, çdo çështje dhe raport e ndërton mbi bazën e të vërtetës e drejtësisë dhe vazhdimisht e kultivon atë. Atribuimi i një fëmije ndonjë prindi të pavërtetë, të shpikur është falsifikim i kësaj të vërtete.

Lidhja familjare në mes të prindërve e fëmijëve dhe në mes të anëtarëve të familjes në Islam është lidhje e fortë e cila ndërtohet mbi lidhjen që formohet nga gjaku dhe prejardhja e përbashkët, e jo sipas marrëveshjeve dhe dëshirave të tyre. Prandaj edhe Islami e ndaloj martesën në mes të afërmve, për ta ruajtur këtë lidhje të fortë.

Nëse lidhja në mes të familjarëve ka ndodhur me shtrembërimin e të vërtetës, atëherë paraqiten probleme që burojnë nga vetëdija se kjo familje është artificiale dhe nuk e ka atë lidhshmëri të gjakut dhe prejardhjes së përbashkët. Kjo mes të afërmve shkakton pabarazi, nënçmim, grindje, armiqësi, incest dhe dukuri tjera negative. Për këtë shkak sistemi i adoptimit kundërshtohet me fundamentet e ligjit hyjnor dhe moralet e larta.

Ruajtja e të drejtave të trashëguesve është obligim të cilin e mbron Islami dhe kjo trashëgimi u takon pasardhësve të vërtet (që kanë afërsinë nga gjaku). Po që se ne e lejojmë adoptimin duke i lejuar fëmijës së adoptuar të drejtën e pjesëmarrjes në trashëgimi, atëherë cenojmë të drejtat e trashëgimtarëve dhe krijojmë armiqësi në mes të tyre dhe fëmijës së adoptuar.

Adoptimi nuk e realizon të drejtën e atësisë. Ai në fakt tenton ta përligj pretendimin që një njeri të bëhet prind i

“...Nëse themi se Islami ndalon adoptimin, atëherë nuk duhet të kuptojmë se Islami ndalon përkujdesjen ndaj fëmijëve të braktisur...”

ndonjë fëmije. Kështu që kur të thirret dikush në emër të dikujt tjetër që nuk është i tij, kjo thirrje është e falsifikuar, të cilën nuk e pranon as ligj hyjnor e as logjika e shëndosh. Prandaj Allahu i Madhëruar thotë: **“Thërritni të adoptuarit sipas etërve të tyre! Kjo është më e drejtë tek Allahu...”**⁸

Me adoptim i bëhet padrejtësi prindërve të vërtetë dhe njëkohësisht i nëpërkëmbet nderi njerëzor dhe të drejtat e tij si prindër. Është e mundur të thuhet se adoptimi ndodh me heqjen dorë nga atësia e prindërve të vërtete, mirëpo edhe mohimi i atësisë nuk është e drejtë e tyre. Pastaj edhe jo rrallëherë herë ndodh që ata të pendohen, e pas shumë viteve ta kërkojnë rikthimin e kësaj të drejte.

Gjithashtu me adoptim i bëhet padrejtësi edhe fëmijës së mitur, pasi që i ndryshohet prejardhja, prindërit, i shtrembërohet e vërteta dhe ai rritet në këtë formë. Kurdo herë ai do ta kuptojë të vërtetën dhe kjo për shumë nga ata është një goditje e shok që ndikon në personalitetin e karakterin e tij, etj.

Çfarë lloji të adoptimit e lejon Islami:

Nëse themi se Islami ndalon adoptimin, atëherë nuk duhet të kuptojmë se Islami ndalon përkujdesjen ndaj fëmijëve të braktisur, bonjakë dhe ata që kanë nevojë

⁷ Shënon Buhariu dhe Muslimi.

⁸ Ahzab, 5.

për vëmendje e ndihmë. Aq më pak që një familje ta merr për sipër rritjen e edukimin e një fëmije që nuk ka mundësi të rritet në rrethin familjar të tij. Në fakt, një nga gjërat të cilat Islami nxit më së shumti njerëzit është përkujdesja dhe ofrimi i edukimit fëmijëve që kanë nevojë për këtë.

Gjithashtu këtu duhet ta sqarojmë edhe atë se shumë njerëz mendojnë se fëmijët të cilët lindin si rezultat i marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore (zina), janë fëmijë që ndjellin të keqen dhe kështu ata përbuzen, madje edhe ofendohen duke i quajtur fëmijë kopil, etj. Është e vërtetë se Islami ndalon marrëdhëniet jashtëmartesore në mes të një mashkulli e femre dhe e konsideron këtë si një nga mëkatet e mëdha. Mirëpo për këtë mëkat as për së afërmi nuk ngarkohet fëmija i cili lind si rezultat i kësaj marrëdhënie. Është parim në jurisprudencën islame se: **“Askush nuk do ta bartë barrën e tjetrit”**.⁹ Për këtë shoqëria e ka obligim që të përkujdeset për këta fëmijë dhe t’ua sigurojë nevojat të cilat kërkohen për rritjen dhe edukimin sa më të mirë e tyre.

Prandaj duhet ta kemi parasysh se Islami nxit që njeriu, ose familja ta merr për sipër një fëmijë të braktisur, ose jetim dhe ta rrisë e edukojë. Kështu, ai i jep vendbanim, e ushqen, e veshë, e mëson dhe e trajton si fëmijë të vetin por jo edhe t’ia ndryshojë prejardhjen dhe t’ia atribuojë vetës se është fëmijë i tij i vërtetë.

Islami e lavdëron gjestin e tillë dhe njeriun e tillë e shpërblen me xhenet. Allahu i Madhërishtëm në lidhje me këtë thotë:

“Të pyesin ty për jetimët, thuaju: “T’u bëni mirë atyre është vepër e bukur. Nëse jetoni bashkë me ata, dijeni se janë

“...Duhet ta sqarojmë edhe atë se shumë njerëz mendojnë se fëmijët të cilët lindin si rezultat i marrëdhënieve seksuale jashtëmartesore (zina), janë fëmijë që ndjellin të keqen dhe kështu ata përbuzen, madje edhe ofendohen duke i quajtur fëmijë kopil ... ”

vëllezërit tuaj. Allahu di ta dallojë keqbërësin prej mirëbërësit.”¹⁰

Ndërsa Pejgamberi, lavdërimi dhe paqja qofshin mbi të, ka thënë:

“Unë dhe ai që përkujdeset për jetimin, në xhenet do të jemi si këta dy gishta (i ka ngritur gishtin tregues dhe atë të mesëm).”¹¹

Në përfundim edhe një herë e theksojmë se Islami ndalon adoptimin i cili shpie në ndryshimin e prejardhjes së fëmijës dhe falsifikimin e prindërve të tij, pasi që kjo shtrembëron të vërtetën dhe cenon të drejtat e individëve qofshin ata fëmijët e adoptuar, prindërit e vërtetë ose edhe trashëgimtarët. Ndërsa, në anën tjetër, lejon dhe nxitë në përkujdesjen, edukimin dhe rritjen e fëmijëve të cilët kanë nevojë për këtë, sikurse fëmijët e braktisur, jetimë, ata që nuk kanë mundësi të rriten me prindërit e tyre të vërtetë, por duke mos ua ndryshuar origjinën dhe prejardhjen e tyre. ■

⁹ Enam, 164.

¹⁰ Bekare, 220.

¹¹ Shënon Buhariu dhe Ebu Davudi.

RREGULLAT DHE PARIMET E INVESTIMIT



Feja Islame vlerën e drejtësisë e konsideron absolute, prandaj nuk merr në konsideratë humbjen apo fitimin në raport me drejtësinë. Ajo nuk bën dallim ndërmjet bashkëpunëtorit musliman apo jomusliman, drejtësia kërkohet për të gjithë njësoj, ngase ky është një parim gjithëpërfshirës i fesë tonë të çmuar

PËRZGJODHI DHE PËRKTHEU: LLOKMAN HOXHA

Në numrin e kaluar sqaruam domethënien e investimit në Islam dhe dispozitën e tij. Në këtë numër do të sqarojmë disa rregulla dhe parime, të cilat duhet të kihen parasysh për të qenë investimi sa më i frytshëm dhe në përputhje me fenë islame. Ky investim duhet të realizojë objektivat e Sheriatit, qarkullimin dhe zhvillimin e pasurisë, po ashtu në realizimin e komoditetit të përgjithshëm për individin dhe shoqërinë, dhe ushtrimin e detyrës së mëkëmbjes në tokë me gjallërimin dhe zhvillimin e saj. Këto parime janë të shumta, kështu që kemi bërë një klasifikim për t'i përmbledhur shumë prej këtyre rregullave në tema të përbashkëta si vijon: 1. Parimet themelore. 2. Parimet morale. 3. Parimet sociale. 4. Parimet ekonomike.

1. Parimet themelore

Parimet themelore janë ato parime me të cilat Ligjvënësi e ka urdhëruar investitorin musliman t'i besojë ato me një besim të thellë, duke qenë se ato parime drejtojnë sjelljen e investitorit parimisht, dhe i përcaktojnë atij pikënisjet nga të cilat duhet të nisët në investimet e tij, si dhe këto parime përcaktojnë lëvizjet e investitorit në atë formë që të përputhen me objektivat e larta të Sheriatit në ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë.

a. *të besosh se Allahut i takon pronësia absolute e tërë pasurisë*; çdo gjë që ekziston në tokë dhe në qiej dhe në tërë këtë gjithësi, njerëz, kafshë, bimë, gjësende..., janë krijesa të Allahut të Lartësuar. Allahu është Krijuesi, Ai është edhe Pronari absolut, dhe nuk ka asnjë ortak në të. Atij pra i takon edhe e drejta e veprimit absolut sipas Dëshirës së Tij. Pra,

edhe pasuria, të cilën e zotërojnë njerëzit vjen nga krijimi i Tij, dhe Atij i takon pronësia e vërtetë, ndonëse Ai e ka lënë atë në duart e njerëzve, ndonjëherë si dhuratë për ta e ndonjëherë vetëm si një hua me një autorizim për të vepruar sipas kushteve që ka vendosur Autorizuesi.

Kemi shumë ajete në kuran që flasin për këtë domethënie, sikurse Fjala e Tij në suren Maide: 17: ***“E Allahut është gjithë çka ka në qiej dhe në tokë dhe çka ka në mes tyre.”***, po ashtu: ***“Ai është Allahu Zoti juaj, Atij i takon pushteti, kurse ata që i thërrisni në vend të Tij, nuk zotërojnë as sa cipa e bërthamës së hurmës.”*** (Fatir: 13) Për këtë duhet që investitori musliman të ketë bindje të plotë se e gjithë pasuria që ai ka në zotërim, nuk i takon veprimi absolut në të, sepse ai nuk është pronari origjinal dhe i vërtetë i saj, prandaj ai duhet ta përdorë atë pasuri sipas dëshirës dhe udhëzimeve të Pronarit të vërtetë.

b. *të besuarit në mëkëmbjen e pasurisë*; Domethënia e këtij parimi është se Allahu i Lartësuar ka kompetencë t’ia heqë njeriut të drejtën e veprimit në pasuri dhe këtë të drejtë t’ia japë dikujt tjetër, sipas rregullave dhe dispozitave që i ka zbritur në fenë e Tij, ashtu sikurse ka vendosur rregulla dhe parime për mëkëmbjen e pushtetit dhe udhëheqjes. Kjo do të thotë se pasuria që zotërojnë njerëzit është një hua, e cila transferohet ose trashëgohet prej një personi në tjetrin, dhe nuk mund të mbetet përgjithmonë në dorë të një njeriu, gjë që tregon se pronari i vërtetë është i Vetmi, Allahu i Madhëruar, Zoti i gjithësisë. ***“Besoni Allahun dhe të Dërguarin e Tij dhe shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim.”*** (Hadid: 7). ***“Kërkoni ndihmë nga Allahu dhe duroni, sepse toka është e Allahut. Ai ia jep atë trashëgim cilit të dojë prej robërve të Vet.”*** (Araf: 128) Këto ajete dhe të

“Njeriu sado që të fitojë pasuri ajo prapë se prapë do të largohet nga duart e tij, prandaj le të jetë i kujdesshëm se si po e shfrytëzon gjatë jetës së tij dhe në duart të kujt po e lë pas vdekjes së tij...”

ngjashme me to qartësojnë parimin e mëkëmbjes (trashëgimisë) së pasurisë në mesin e njerëzve, këtë e dëshmojnë edhe komentuesit më të njohur të Kuranit:

Ibën Kethiri duke e komentuar ajetin ***“shpenzoni nga ato që Ai jua ka lënë trashëgim”*** thotë: “Allahu ka inkurajuar në shpenzimin e pasurisë, të cilën e keni trashëguar, që do të thotë se ajo pasuri për ju është si një hua, meqë ajo ka qenë në dorë të tjetërkujt më parë, pastaj erdhi te ju, dhe duhet ta shfrytëzoni për të mirë. Si dhe ky ajet tregon se pasuria mund të trashëgohet prej teje, e ndoshta trashëgimtari yt do ta shfrytëzojë pasurinë sipas udhëzimeve të Allahut dhe do të jetë më i lumtur me të se sa ti, ose ndoshta do ta keqpërdorë atë dhe t’i bëjë mëkat Allahut me të, që do të thotë se ti i ke ndihmuar atij me pasurinë tënde të mos i bindet Allahut.”¹ Pra njeriu sado që të fitojë pasuri ajo prapë se prapë do të largohet nga duart e tij, prandaj le të jetë i kujdesshëm se si po e shfrytëzon gjatë jetës së tij dhe në duart të kujt po e lë pas vdekjes së tij.

c. *dëshira për të arritur kënaqësinë e Allahut në investim*; Çdo punë që bën muslimani në jetën e tij ka një qëllim, dhe varësisht nga qëllimi i tij pranohet ose refuzohet vepra e vet, si dhe mbi këtë parim

¹ Ibën Kethiri, Tefsir Kurani l-Adhim, v.6, f.99

ndërtohet edhe çështja e shpërblimit apo e ndëshkimit të tij. Në Kuran kemi ajete të shumta që flasin dhe inkurajojnë në nxitimin për të arritur kënaqësinë e Allahut gjatë punëve të dynjasë prej tyre:

“Vetëm tek Allahu kërkoni risk dhe adhuroni e falënderoni vetëm Atë.” (Araf: 17) si dhe ***“Ndërsa ai që është më i devotshëm do të jetë larg tij*** (zjarrit). ***Ai që e jep pasurinë e vet e pastrohet, duke mos pritur shpërblim prej dikujt tjetër për këtë, por vetëm për të kërkuar Fytyrën e Allahut, më të Lartit. Ai padyshim që do të fitojë kënaqësi.”*** (Lejl: 17-21).

Këto ajete dhe shumë tjera tregojnë qartë domosdoshmërinë e kujdesit, që duhet të ketë investitori musliman në realizimin e këtij parimi në investimet e tij. Ky parim konsiderohet nga parimet më të rëndësishme, të cilat rregullojnë sjelljen njeriut. Është një parim preventiv nga investimi i pasurisë së tij në atë që e hidhëron Allahun dhe e mbron nga zhytja në aktivitete financiare, të cilat nuk ia realizojnë këtë qëllim dhe nuk e lë të humbasë pasurinë e tij në gjëra të ndaluara, që në fund të arrijë kënaqësinë e Allahut në këtë dhe në botën tjetër.

2. Parimet morale

Parimet morale janë një grumbull me rregulla dhe vlera morale, të cilat drejtojnë sjelljen e investitorit musliman në atë formë, që të përputhen me objektivat e larta të Sheriatit në ruajtjen dhe zhvillimin e pasurisë.

a. *parimi i vërtetësisë në investim;* Investitori musliman duhet t'i përmbahet vërtetësisë në fjalët e tij gjatë shitblerjes, pa marrë parasysh pasojat materiale që pasojnë nga kjo gjë, duke iu përmbajtur urdhrave të Allahut në çdo situatë të tij. Ky parim është shumë i rëndësishëm për disa arsye: **I.** investimi është një aktivitet financiar, i cili ndërtohet mbi këmbimin e pasurisë, gjë që e mban njeriun vazhdimisht në lidhje me

“Investitori musliman duhet t'i përmbahet vërtetësisë në fjalët e tij gjatë shitblerjes, pa marrë parasysh pasojat materiale që pasojnë nga kjo gjë...”

tjetrin e për pasojë gjë që kërkon vërtetësi në çdo kohë dhe në çdo vend. **II.** Investimi është një aktivitet i dyanshëm dhe kërkon pajtimin e njerës palë me atë që thotë pala tjetër, gjë që mund të mashtrohet njëri nga fjalët e tjetrit, dhe për këtë muslimani flet vetëm të vërtetën, qoftë shitës apo blerës. **III.** Vërtetësia në investim i sjell dobi të shumta investitorit, ngase përhapet lajmi për të dhe njerëzit do t'ia mësyjnë atij, sepse kanë shumë nevojë për besueshmërinë, e cila është një cilësi munguese tek tregtarët e sotëm.

Vërtetësia është një virtyt me të cilin duhet të shquhet besimtari në çdo rast dhe për këtë kemi shumë ajete në Kuranin e Madhëruar, si ajeti:

“O ju që keni besuar kini frikë Allahut dhe qëndroni me të vërtetët.” (Teube: 119) dhe ajete të tjera të ngjashme. Kur flasim për rëndësinë e vërtetësisë automatikisht kuptojmë se e kundërta e saj është e ndaluar rreptësisht, pra gënjeshtria, e sidomos kur kësaj i shoqërohet betimi në Allahun, që jo rrallë e dëgjojmë në tregjet tona. Ebu Dherri, *radijallahu anhu*, na përcjell, se Lajmëtar i Allahut (lavdërimi dhe shpëtimi i Tij qoftë me të) ka thënë: ***“Tre personave Allahu nuk u flet Ditën e Kiametit, nuk i shikon, nuk i pastron dhe për ata ka një dënim të dhembshëm”*** dhe ndër ta përmendi personin ***“që shet mallin e tij me betim të rrejshëm”***. (Muslimi)

b. *parimi i besueshmërisë gjatë investimeve;* Besueshmëria është kapitali kryesor i investitorit dhe shtylla më e rëndësishme e suksesit të tij. Ai tregtar, i cili është i besueshëm, e sheh se njerëzit nxitojnë

për të bashkëpunuar me të, në këtë mënyrë atij i shtohen fitimet, dhe arrin kënaqësinë e Allahut dhe pëlqimin nga njerëzit. Për rëndësinë dhe vlerën e besnikërisë kemi shumë argumente, prej tyre:

“Edhe ata që janë besnikë ndaj amanetit që u është besuar dhe ndaj premtimit të dhënë. Edhe ata që dëshminë e vet e zbatojnë (nuk e mohojnë, nuk e fshehin). Edhe ata që janë të kujdesshëm ndaj rregullave të namazit të tyre. Të tillët janë në Xhenete dhe janë të nderuar.” (Mearixh: 32-35).

Enesi (kënaqësia e Allahut qoftë me të) na tregon, se i Dërguari i Allahut (lavdërimi dhe paqja e Allahut qoftë me të) ka thënë: *“Nuk ka iman ai që nuk ka besnikëri, dhe nuk ka fe ai që nuk ka besë.”* (Ahmedi- Arnauti: hasen)

c. parimi i zbatimit të kontratës gjatë investimeve; aktiviteti ekonomik në përgjithësi dhe ai investues në veçanti ndërtohet mbi këmbimin e interesave, parave dhe mallrave, gjë e cila kërkon vazhdimësi të lidhjeve dhe raporteve mes palëve. Njëra palë sigurisht ka të drejtat e veta, të cilat duhet t'i përmbushë pala tjetër në mënyrë reciproke, duke qenë kështu duhet patjetër që të dy palët të jenë të stolisur me vendosmëri në përmbushjen e detyrimeve dhe zbatimin e detyrave sipas marrëveshjes mes tyre. Kur secila palë i përmbahet asaj që i takon, qoftë detyrim ndaj palës tjetër apo e drejtë që i takon, atëherë kjo garanton vazhdimësinë e punës dhe aktivitetit të ndërsjellë. Prandaj zbatimi i kontratës konsiderohet nga rregullat kryesore mbi të cilat ndërtohen raportet e ndërsjella. Allahu i Lartësuar në librin e Tij, në mënyrë të prerë na urdhëron të jemi të kujdesshëm për kontratat dhe marrëveshjet që bëjmë: ***“O ju që besuat! Zbatoni premtimet*** (detyrimet).” (Maide: 1).

ç. Parimi i drejtësisë në investime; Nëse aktivitetet investuese synojnë që secila palë të arrijë sa më shumë fitim dhe të shmangin sa më shumë humbje, atëherë duhet ditur se

rruga e vetme për të arritur këtë qëllim për të gjithë pjesëmarrësit në këtë garë, duhet që të gjithë t'i përmbahen parimit të drejtësisë, ashtu që mos të dëmtohet asnjëra palë, dhe të mos fitojë duke e shtypur tjetrin. Koncepti i sistemeve ekonomike bashkëkohore dallon për sa i përket drejtësisë dhe e konsiderojnë si një vlerë relative, por jo absolute. Drejtësia sipas tyre është një vlerë fisnike në rastet kur ajo u sjell dobi dhe interesa, ndërsa nëse i përmbahesh drejtësisë të shkakton humbje ose dëme, atëherë nuk konsiderohet vlerë morale, dhe nuk duhet t'i përmbahesh asaj. Duke u bazuar në këtë pikëpamje të pjesshme të drejtësisë nga ana e kapitalizmit shohim se ata nuk e kanë problem, që ekonomia të ngrihet në bazat e kamatës, ose përthithjes së pasurisë së të dobëtëve dhe të varfërve, si dhe nuk i pengon përhapja e monopolizimit në shoqëri, përderisa ajo u sjell atyre dobi dhe fitime të shumta.

Feja Islame vlerën e drejtësisë e konsideron absolute, prandaj nuk merr në konsideratë humbjen apo fitimin në raport me drejtësinë. Ajo nuk bën dallim ndërmjet bashkëpunëtorit musliman apo jomusliman, drejtësia kërkohet për të gjithë njësoj, ngase ky është një parim gjithëpërfshirës i fesë tonë të çmuar dhe nuk ndryshon sipas kohës, vendit apo rastit, afërsisë, miqësisë etj.

“O besimtarë! Bëhuni të qëndrueshëm në urdhrat e Allahut dhe bëhuni dëshmuar me drejtësi. Kurrësi urrejtja që keni ndaj disa njerëzve nuk duhet t'ju shtyjë të bëheni të padrejtë. Bëhuni të drejtë, se kjo është më afër devotshmërisë dhe frikësujni Allahut! Pa dyshim, Allahu është i Dijshëm për çdo gjë që punoni ju.” (Maide: 8). Kemi edhe shumë argumente të tjera, që tregojnë se drejtësia është një virtut absolut, dhe konsiderohet objektiv i sheriatit, si dhe është një mjet i rëndësishëm për thirrjen e të tjerëve në fenë e Allahut të Madhëruar.■

(vijon në muajin e ardhshëm)



SPEKTAKLI I BESIMTARES

Spektakli i saj nuk është i rrethuar me kamera 24 orëshe, e brenda asaj periudhe të tregojë talentin e aftësitë e saj, apo dhe të shfaqë privatësinë e saj, dhe të shpresojë në shpërblimin e kësaj loje. Jo jo, kjo nuk ndodh te muslimanja

SHKRUAN: DRITA N. MALIQI

Gruaja muslimane është grua famëmadhe. Historisë së saj nuk mund t'i afrohesh as nga afër, por as edhe t'i përngajë ndonjë grua tjetër. Jeta e saj peshon shumë aty ku peshohet burrëria e femrës së kësaj bote. Të respektuara dhe mbretëresha, të cilat udhëheqin dhe ruajnë mbretërinë e tyre. Ruajnë nderin dhe kujdesin ndaj familjes,

edukimin dhe rritjen e fëmijëve të tyre, ku gjithçka tjetër nuk mund të zërë vendin e këtyre prioriteteve. Tërësia e saj është në dukjen e saj të kompletuar, paraqitet e dalluar me pamjen e saj të jashtme. Namin e ka të madh, zanafilla fillon me nënën e njerëzimit, Havanë *alejha selam*.

Një ditë kur po flisnim me një shoqen time e një kombi e feje tjetër, po më tregonte se në punimin e saj në lidhje me femrën në biznes, kur po kërkonte për historinë e gruas

në tregti, në hulumtimet e saj të gjitha burimet e kishin quar tek Hatixheja *radijallahu anha*. Këtë të fundit e kishin cilësuar për të zgjuar dhe tregtare të suksesshme. Paskëtaj biseduam disa gjëra në lidhje me këtë, u bë si u bë u hap tema, pastaj ajo nisi të më tregojë për një protagoniste femër në fenë e saj. Rrëfente se si një femër në atë kohë për ta luftuar realitetin që e nënçmonte femrën e asaj kohe i është dashur të vishet e të jetojë si djalë. Ajo e tregonte me aq entuziazëm guximin e saj, ku përfundoi së treguari historinë e saj, duke i ardhur keq se atë pastaj e paskan zbuluar pasi kanë marrë vesh, se ajo ka mbetur shtatzënë jashtë lidhjeve martesore, pastaj ajo tregonte se çfarë i ka bërë kisha në lidhje me këtë, por unë mendoja me vete: “ah Hatixhe, ah Sumeja, ah nënat e besimtarëve, ah bashkëkohëset e Muhamedit, *sal-lallahu alejhi ue selem*, të pastra, të zonja, gra shembull për të gjitha kohët. A kam të drejtë kur them se nuk i afrohet asnjë grua pra.

Na përcillet nga Ebu Udhejne es Sadefiju, ku i Dërguari i Allahut *alejhi salatu ue selam* ka thënë: “*Gratë tuaja më të mira janë ato të dashurat (të përzemërtat), që lindin shumë, të bindura, përkrahëse në qoftë se i frikësohen Allahut, e gratë tuaja më të këqija janë ato të zhveshurat e mendjemëdhatë, ato janë hipokritet. Nuk hyn në Xhenet asnjë prej tyre, e shembulli i tyre është si korbi el-easam.*” (Bejhakiu ne Sunen el-Kubra)

1. Spektakli i saj nuk është i rrethuar me kamera 24 orëshe, e brenda asaj periudhe të tregojë talentin e aftësitë e saj, apo dhe të shfaqë privatësinë e saj, dhe të shpresojë në shpërblimin e kësaj loje. Jo jo, kjo nuk ndodh te muslimanja. Sepse jeta e saj është e vërtetë, e rrethuar me “kamera” në jetën e saj nga Mbikëqyrësi Absolut. Edukon shpirtin e zemrën me Islam, zhvillon aftësitë dhe kapacitetet për Islamin, strehohet tek Allahu, bën ibadete dhe punë të mira, në vetmi e në shoqëri. Para Krijuesit del me

“...Dalja nga shtëpia që nuk bëhet pa u shikuar mirë në pasqyrë, nuk është për të parë sa është tërheqëse, por për të parë a është veshur në rregull siç duhet....”

nder, mirësjellje dhe me petkun e devotshmërisë. Hartën e punës e vizaton me parime Islame e urdhra kuranore. Premia kryesore që e brengos atë është arritja e shpërblimit të madh, Xhenetet e Allahut të Lartmadhëruar.

Ajo i ruan thesaret e çmueshëm me xhelozi në shtëpinë e saj. Shqiponjë që nuk guxon askush t’ia prekë folenë që ajo ndërton. Edukon e rrit brezat e ardhshëm dhe më të mirë s’mund të gjesh. Kur të tjerët i frikësojnë fëmijët e tyre me ‘shtrigat e natës’, ‘macen e zezë’, ajo mbjell në zemrën e fëmijës guxim, trimëri e qëndrueshmëri. A nuk e paska pra profesionin lider, kujdestare, e edukatore e një Umeti të tërë.

2. Besimtarene e gjejmë në shumë raste, ku me dinjitet paraqet dhe mbron fenë e saj. Keni parë apo keni qenë dëshmitarë në ndonjë debat qoftë në shoqëri apo në kuzhinën mediatike, apo qoftë në rrugë si kalimtare e rastit, se si i vërsulen muslimanes. Por një sjellje e bukur dhe me edukatë të pastër e një besimtareje muslimane, gjithmonë ua ka prishur kurthet e kurdisura e nëpërkëmbëzat e hartuara të shumë gazetarëve, apo armiqve të saj. Shpesh të përgatitur e të stërpërgatitur, gazetarë të ndryshëm, nuk iu ka munguar zelli ta paraqesin femrën muslimane të shtypur e të prapambetur. Çuditërisht ka ndodhur shpesh, që të befasuar nga edukata

e mirësjellja, nuk kanë ditur nga ta çojnë timonin e debatit për t'i dhënë kuptim atij. Pas kësaj kanë filluar me pyetje rreth fesë Islame apo jetës së saj në përgjithësi. Me këto vorbullime mediatike nuk po shkoj askund më larg sesa në vetë trojet tona shqiptare. Një fjalë e urtë thotë: *“Femrën e nderon vetëm i nderuari dhe e përbuz vetëm i përbuzuri”*.

Pamja e muslimanes, që duhet të jetë e pastër dhe në pajtim me sheriatin, nuk i ngjan atyre që iu kushtojnë rëndësi veshjes së tyre tërheqëse. Në grimin e saj pra, janë nderi, modestia, sinqeriteti, mirësjellja e njohuria. Dalja nga shtëpia që nuk bëhet pa u shikuar mirë në pasqyrë, nuk është për të parë sa është tërheqëse, por për të parë a është veshur në rregull siç duhet.

3. Zgjidhjen e problemeve në familje, metodat për edukimin e fëmijëve, zhvillimi i çerdhes së saj, nuk e ngatërron me jetën e atyre të filmave. Ajo i mëson ato gjëra që i duhen nga i Gjithëdijsmi Absolut, nga Kurani dhe Suneti. Dhikri (të përmendurit e Allahut), që ndihmon të ngjallësh zemrën. Ligjëratat javore në vendin e saj, pastaj dëgjimi i serive të ligjëratave nga dijetarë të çmuar. Përcjellja e jetës së më të dashurve të Allahut, jetën e pejgamberëve. Njihet me jetën e grave më të dashura të drejta, gratë e inspiruara nga më i dashuri, Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem*.

4. Pra, kjo është muslimanja. Skalite mirë në shpirt figurën e muslimanes. Ji në rrugën e luanëve, prandaj çdo gjë që ndodh apo del rrugës, qoftë shkëmbinj a gurë, e mos të flasim për guralecë, nuk të ndal në realizimin e synimit tënd për mëkëmbjen e Umetit. ■

ROLI ROBËRUES I MEDIEVE

Inskenohen situata për të rritur shikueshmërinë, e njëherësh edhe përhapjen e këtyre antivlerave tek të rinjtë. Pas gjithë këtij skenari të bën të mendosh: A është shoqëria shqiptare e verbuar përpara vlerave materiale, që të tregtojnë me çdo detaj të jetës e nderit të tyre?!

SHKRUAN: BURBUQE REXHA

Është e njohur që nga historitë e popujve të mëhershëm se jo çdo informatë, me të cilën njerëzit janë informuar që në fillim ka qenë po ajo e “vërtetë”. Sado që shumë të vërteta tashmë janë kuptuar, edhe sot e kësaj dite akoma ngelet shumë për të mësuar...

Duke pasur parasysh rregullin e vjetër se “Informacioni është fuqi”, ndërsa duke mos pasur mundësi gjithmonë për të bllokuar rrjedhjen e informatave sikurse në vitet e mëhershme, atëherë zgjidhja ishte pak më ndryshe por shumë efikase, njëherësh edhe teknologjia më e zhvilluar e kohëve të sotme - dezinformimi.

Parimi i tij është shumë i thjeshtë, në esencë ai duhet të krijojë stadi mendore dhe psikike tek njerëzit hera-herës,



kështu duke kontrolluar ndjenjat e tyre dhe duke shkaktuar dashuri për diçka (edhe pse ajo në realitet mund të jetë e dëmshme), dhe urrejtje për diçka tjetër (edhe pse në realitet ajo mund të jetë e dobishme). Pra, thelbi i dezinformimit është që të krijojë tek mendjet e njerëzve përkufizime për dukuri të ndryshme shoqërore dhe njëherësh e vendos masën të mbajë njërin krah apo një tjetër.

Në ndryshim nga teknikat e vjetra për të imponuar doktrina të ndryshme, siç bënin më parë, dezinformimi është shumë më efikas dhe i fuqishëm, pasi e manipulon audiencën në nivelin racional, duke bërë me këtë, që edhe gjëra që janë shumë rationale dhe të logjikshme të kthehen në tabu dhe e njëjta audiencë u kthehet kundër duke i sulmuar me gjithë fuqinë e tyre, edhe pse ato mund të jenë në favor të tyre.

Shembujt dhe mjetet të dezinformimit

Jetojmë në kohën kur lajmi shpërndahet me shpejtësinë më të madhe të mundshme, media të shumta elektronike, dhe të shkruara, çdo ditë me zhvillime marramendëse të shpejtësisë së informimit apo dezinformimit. Duke bërë e dhënë gjithmonë vetëm atë që i përshtatet një shoqërie të caktuar. Shumë e shumë luftëra u kryen në emër të “vërtetave” të famshme të tyre, u krijuan histori të rreme e komplete, duke sajuar veprimet më çnjerëzore të mundshme. Mijëra e mijëra jetë të pafajshme u shuan, ku akoma edhe sot e kësaj dite vazhdojnë të vriten me të njëjtat pretekste të imagjinuara, të trilluara, të pakuptimta me një fjalë. Ndërsa në anën tjetër dekorohen, lavdërohen për demokraci dhe të drejta të njeriut... ky ishte dezinformimi i dhimbshëm e i njohur tashmë i shteteve komuniste. E shumë e shumë ngjarje të

tjera të panumërta, ku secila në një anë apo në një tjetër mbart tek njerëzit bagazhe me histori pafund dhimbjesh.

Sprovat e modernizuara

Pejgamberi ynë *sal-lAllahu alejhi ue selem* na ka paralajmëruar të mos bëhemi robër të askujt tjetër përveç Allahut dhe që të kemi kujdes nga këto sprova, duke theksuar rrezikun e tyre tha: *“Frikësojuni dynjasë dhe frikësojuni grave, sepse me të vërtetë e para fitne te Beni Israilët kanë qenë gratë”*.

Pra, mu në këto pika shumë të ndjeshme sot njerëzit “goditen” dhe përmythen nga të gjitha anët me slogane të shumta e të njohura të sistemeve bankare për kredi: “Për një jetë më të mirë”, apo “Bëje jetën tënde më të lumtur”, pra të krijohet ideja që sa më shumë njerëzit të mbledhin të mira materiale, aq më të lumtur do të jenë. Kështu duke i kthyer ata në skllevër mesjetarë, pasi njeriu vendos si qëllim kryesor të jetës së tij shtimin e pasurive materiale, hera-herës duke flijuar edhe gjërat me të dashura. Bile edhe veten e vet dhe harron që sa më shumë të ketë, aq më shumë do të dëshirojë. Gjithmonë do të mbetet i preokupuar në shtimin e tyre dhe në të njëjtën kohë i shqetësuar, nëse fillon pakësimi apo humbja e saj. Në një intervistë lajmesh me një nga punonjësit e bankave në vendet tona, kur po flitej për interesat e larta të kredive, që kishim ne në vendin tonë, për dallim nga shtetet në rajon “Jo që është zvogëluar interesimi për kredi, edhe me këto interesa që kemi, por nuk kemi kapacitete të mjaftueshme për të dhënë aq kredi sa kërkon tregu”,-deklaronte ai. Është shumë shqetësues ky fakt, ku është duke shkuar shoqëria jonë? A mund t’i thuhet “jetë”, duke hyrë në luftë me Allahun?! Çfarë lumturie e suksesi mund të jetë kur bëhesh “rob i dynjasë”?!...

“...Frikësojuni dynjasë dhe frikësojuni grave, sepse me të vërtetë e para fitne te Beni Israilët kanë qenë gratë...”

“Nuk kam lënë pas meje fitne (sprovë) më të madhe se sa fitneja (sprova) e grave”.

“Goditja” tjetër e radhës e sloganit shumë të njohur “emancipimi i femrës”. Në emër të po këtij emancipimi sot shohim, që aq shumë është keqpërdorur e manipuluar figura e femrës, saqë atë e gjen kudo me pamje joshëse, të vërteta apo në forme letre, apo edhe me dritë tek reklamat. Çdo kund të ndjekin këto imazhe të përsëritura e të përsëritura të produkteve ushqimore, apo teknologjike, që nuk është fare e nevojshme prezenca e saj dhe as që ka lidhje me cilësinë, dhe kualitetin e produkteve në fjalë, dhe që të bëjnë të mendosh cilën prej tyre promovojnë në të vërtetë. E gjen me buzëqeshje të vazhdueshme, deri sa të paguani çmimet e shtrenjtuara të produkteve në qendrat tregtare, apo në dyqane e shërbime të tjera. Shpeshherë imponuese me zërin, sharmin, pamjen e tyre gjithmonë të përzgjedhur, e të rregulluara sipas modës së fundit. Porse mbas kësaj pamje qëndron një industri e tërë, që nga disenjatorët (e që shumica e tyre janë meshkuj, që nuk është fare për t’u çuditur nga mënyra e stilimit) e deri tek grimi, krehja e saj, orë të tëra parapërgatitjesh. Më e çuditshmja është se e gjen edhe tek kopertina e “menysë” së pasticerisë me zë. Apo nga ajo e përditshmja, ku është e pamundur të hapësh postën elektronike dhe të mos hasësh çdo ditë pamje e foto të tyre gjithmonë nga më të ndryshmet. Tek lajmet e ditës, revistat, apo në gazetatat

ditore, kudo nga formatet me të minimizuara e deri tek ato më të mëdha, duke u thirrur në emër të barazisë dhe të lirisë së saj. Kur jemi tek kjo e fundit lirisht mund të themi, se tashmë kjo e ka humbur kuptimin, kjo paraqitje me mendjen e kthjelltësisë nuk quhet më liri, kjo është robëri, zhvlerësim komplet i natyrshmërisë së qenies njerëzore.

Televizioni- bashkimi i fotografisë, zërit, lëvizjeve dhe ngjyrave, ndikimi në të tre sferat e pranimit të informacionit, dëgjimit, pamjes dhe efektet lëvizëse, këto kombinime kanë ndihmuar e lehtësuar, që të bëhet ar(miku) i rregullt edhe i shoqërisë shqiptare. Duke i kursyer nga bisedat mes vete familjare, me fëmijët, bile nganjëherë edhe ndonjë mysafir i bashkëngjitet po kësaj “drame” pa fjalë, të ngrirë para ekraneve e që vërshojnë me muzikë, spektakle, seriale, si dhe fenomeni i ri dhe shumë i përfolur tanimë në media, rrugë, shkollë, lokale urbane, kudo! Është fjala pra për spektaklet “*reality show*” si: “*Big Brother*” apo “*Shpija*”, ku çdo gjë tjetër mund të ofrojnë përveç vlerave.

Qëllimi i këtyre spektakleve është përfitimi material. Jo vetëm kaq, qëllimi i gjithë kësaj është nga ato të reja e të rinj të krijohen situata e të nxirren mes tyre veset, intrigat, veprimet shfrenuese më të ulëta, që mund të ketë një shoqëri. Inskenohen situata për të rritur shikueshmërinë, e njëherësh edhe përhapjen e këtyre antivlerave tek të rinjtë. Pas gjithë këtij skenari të bën të mendosh: A është shoqëria shqiptare e verbuar përpara vlerave materiale, që të tregtojnë me çdo detaj të jetës e nderit të tyre?!

Para gjithë kësaj pjesa më e ndjeshme janë fëmijët. Ata janë të ekspozuar më gjatë para këtyre antivlerave, duke krijuar “idhujt” e tyre, që ndyjnë natyrshmërinë e

tyre të pastër. Është për t'u lavdëruar shembulli i një nëne të re muslimane shqiptare, jo se ajo nuk humbet kohën e çmuar të saj, duke shikuar seriale, por me gjithë angazhimet që kishte, ajo kishte gjetur kohë për të krijuar e qepur veshje me personazhe lodër, duke krijuar çdo ditë atmosferë festive tek fëmijët e saj, njëherësh duke i mbajtur larg lojërave kompjuterike me efekte dhune, apo filmave vizatimorë me pamje e skenar me mesazhe të fshehura. “Vërtet duhet kohë, mund dhe energji, por të paktën nuk do të lodhem të rikthehem prapë për të korrigjuar defektet që krijojnë filmat dhe lojërat që shfaqen sot për fëmijë.” -thoshte ajo e ngazëlluar, se përveç lodhjes i jep shumë kënaqësi misioni i saj i shenjtë. Janë po këto muslimane që paragjykojnë për shkak të mbulimit, veshjes, paraqitjes së tyre e akoma “përrashtohen” nga po kjo shoqëri, e ndërkaq këto motra të nderuara do të edukojnë kuadro e breza të rinjsh me ambicie më të larta nga shembujt e besimit.

Pas gjithë kësaj rrëmuje e goditje dallgësh nga shumë anë, me mënyra e mjete të ndryshme, ne duhet të kemi shumë kujdes, të ruajmë veten, familjen, e gjithë shoqërinë nga këto kthetra të fshehura. Në jetë ekzistojnë dy thirrës: Thirrësi në Mëshirën e Allahut, që të fton në Kënaqësinë dhe Dashurinë e Tij. Apo thirrës që thërret në të kundërtën e saj. Epsh që urdhëron në të keqe, teka e dëshira që tërheqin drejt një përfundimi shkatërrues në të dy jetët. A e keni menduar, se kë thirrës duhet të ndiqni gjithmonë, apo tek cili thirrës bën pjesë ti?! ■

VAJZA JOTE ËSHTË BËRË GRUA, A E BESON?!



. Kurse për sa i përket burrave të këtyre vajzave në kësaj rastesh hasim burra që bëjnë durim me gratë e tyre, dhe hasim burra që nuk bëjnë durim, dhe fillojnë problemet mes tyre, ku mundet të përfundojnë edhe me ndarje mes bashkëshortëve, e në fund ata që akuzohen janë prindërit, e në veçanti nëna

JAHJA EL BULINI

Ekziston një ditë, një moment, një çast, kur çdo baba dhe nënë e paramendojnë se është i largët dhe besojnë, se nuk do të vijë shumë shpejt. Ajo ditë është kur ata e shohin vajzën - që dikur zvarritej - para tyre

si nuse, e cila niset për në shtëpinë e burrit të saj dhe fillon jetën e saj të re, të përbërë prej një familjeje me anëtarë të rinj.

Shumica e prindërve vajzat e tyre gjithmonë i trajtojnë si fëmijë. Prandaj përgatitja e tyre për atë ditë të rëndësishme në shumicën e rasteve është vetëm në

aspektin material, kjo më tepër duke blerë disa nevoja për nusen dhe për dasmën. Ata harrojnë një çështje, që është më e rëndësishme, më e rrezikshme dhe është shkak për lumturinë e vazhdueshme në jetën e fëmijës së tyre, e ajo është mësimi i asaj me atë që: çka do të thotë të jesh bashkëshorte.

Ata mendojnë, se para tyre kanë shumë kohë për t'ia mësuar e shpjeguar asaj çdo send rreth martesës, dhe për atë shkak e neglizhojnë ngulitjen e botëkuptimit të fjalës *bashkëshorte*, qëllimet e saja, mjetet e saja dhe elementet përbërëse të saja. Harrojnë se në shoqëri ekzistojnë çerdhe edukimi dhe faktorë ndikues, ku t'i edukojnë fëmijët e tyre me të njëjtat tematika, por me një pasqyrë krejtësisht të kundërt që e lejon Islami dhe e dëshirojnë prindërit muslimanë për fëmijët e tyre. Si rezultat i kësaj vjen një brez i ri vajzash, të cilat prej çështjeve të martesës dinë vetëm për fustanin e bardhë, termin “nuse”, përgatitjen e shtëpisë bashkëshortore dhe radhitjen e mobileve të asaj shtëpie. Kur vjen ajo ditë që e ëndërron çdo vajzë, këto mbretëresha fillojnë jetën e tyre bashkëshortore, por me bindje dhe mendime të formuara dhe ndikuara prej faktorëve të jashtëm. Ato bindje në shumicën e rasteve janë se martesë është një aventurë e ëmbël, me shumë udhëtime dhe shëtitje. Ajo ka bindjen se bashkëshorti e dashuron atë deri në atë gradë, sa që vepron çdo send që ajo dëshiron për të realizuar kënaqësinë e plotë që ajo ëndërron. Mendon se s'ka nevojë të ndërhyjë askush dhe të veprojë asgjë për shpëtimin e kësaj marrëdhënie bashkëshortore dhe se ajo thjesht shkon tek ai për t'u kënaqur me një jetë të re, të sigurt, të qetë dhe të kënaqshme.

Shumica e njerëzve e neglizhojnë edukimin dhe përgatitjen e vajzave për një

jete të re me një burrë, që nuk e njeh më herët dhe nuk ia njeh karakterin dhe tiparet e tij. Ky burrë do të bëhet gjatë natës dhe ditës njeriu më i rëndësishëm në jetën e saj, kënaqësia e tij dhe respektimi i tij do të bëhet për bashkëshorten derë prej dyerve të Xhenetit. Pas kësaj nuk mbetet për atë grua gjë tjetër veçse përkujdesja për pesë kohët e namazit, të agjërojë një muaj në vit dhe të mbrojë nderin e saj, derisa të thërritet në Ditën e Gjykimit dhe të zgjedhë cilën derë të dëshirojë ajo prej Xhenetit. Na përcjell imam Ahmedi nga Abdurrahman ibën Aufi, i cili thotë: Pejgamberi, *sal-allahu alejhi ue selem*, ka thënë: “Ajo grua që i fal pesë kohët e namazit, agjëron Ramazanin dhe e respekton burrin e saj, i thuhet hyn në Xhenetin e Allahut prej cilës derë dëshiron”. Po ashtu hadithin e përcjell Ibën Hibani në Sahihun e tij, dhe Shejh Albani thotë se hadithi është i vërtetë. Për këtë shkak ajo obligohet të përgatitet me të vërtetë dhe seriozisht për martesën. Duhet të veprojë, të mendojë dhe të kontribuojë rreth asaj, se si ta arrijë këtë shpërblim të madh, i cili ecën paralelisht dhe i përgjigjet gjithë asaj që e veprojnë burrat prej nënshtrimeve, si xhihadin, namazin me xhemat dhe ditën e Xhumasë.

Një ditë shkoi Esmā bint Jezid ibën es-Seken el-Ensarije, *radijallahu anha*, e njohur edhe me emërtimin hatibja (ligjëruesja) e grave, tek Pejgamberi, *sal-allahu alejhi ue selem*, dhe i tha: “O i Dërguari i Allahut. Allahu të dërgoi për të gjithë njerëzit, burra dhe gra, dhe ne të besuam ty dhe Zotin tënd. Ne gratë jemi të përkufizuara, të mbyllura mes katër mureve, jemi mbajtëse dhe kujdestare e shtëpive tuaja, bartëse e fëmijëve tuaj, por ju o burra u dalluat dhe u parapëlqyet ndaj nesh me prezencën e bashkësisë dhe xhemateve, me prezencën e xhenazes, me vizitën e të sëmurëve, pastaj u dalluat dhe u parapëlqyet ndaj nesh me

shkuarjen në Haxh pas Haxhi, dhe më e madhe se kjo, shkuarjen në luftë për hir të Allahut. Një burrë prej jush, kur merr rrugën për në Haxh, apo Umre, apo Xhihad, ne mbesim në shtëpitë tuaja, kujdesemi për pasurinë tuaj, edukojmë fëmijët tuaj, qepim rrobat tuaja. Prandaj, a marrim pjesë edhe ne gratë në atë çka ua ka dhënë Allahu prej të mirave dhe shpërblimeve? – Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, u kthye me trupin e tij, dhe tha: “*A dini ndonjë grua, që ka pyetur për çështjet e fesë së saj më mirë sesa kjo grua*”.

Gratë thanë: O i Dërguari i Allahut, nuk e kemi paramenduar, se një grua mund të bëjë një pyetje të tillë. Pastaj Pejgamberi, *sal-lallahu alejhi ue selem*, tha: “*O ti Esma, kupto prej meje atë çka do të them. Tregoju gjithë grave të tjera, se ajo grua që është bashkëshorte e mirë ndaj burrit të saj, e respekton dhe i nënshtrohet urdhrave të tij, ia plotëson të gjitha dëshirat e tij, është e barabartë me krejt atë që vepron burri*”. U kthye Esmaja dhe e madhëronte me vete Allahun duke përsëritur fjalinë: “*është e barabartë me krejt atë që vepron burri, është e barabartë me krejt atë që vepron burri*”. (Bejhakui, në librin e tij *Shuab el Iman*)

Të parët që duhen dhe detyrohen të kujdesen për këtë edukatë të dëshiruar dhe synuar janë prindërit. Ata janë të parët që do të mallkohen dhe akuzohen, në rast se e neglizhojnë dhënien e kësaj edukate vajzës së tyre, dhe janë të parët që do të mallkohen nga ana e vajzës së tyre, kur ajo nuk do të mund ta kryejë rolin e saj të duhur si bashkëshorte. Si rezultat i kësaj edukate ajo ndoshta do të kthehet në shtëpinë e babës së saj, por me një epitete të ri, si e shkurorëzuar apo e ndarë. Sipas një studimi zyrtar, viti i parë i martesës është viti kur edhe ndahet më shumë burri prej gruas së tij. Në vazhdim do t'i cekim disa

“...Shumica e vajzave në ëndrrat e tyre e imagjinojnë bashkëshortin me cilësi dhe veti të plota, që realisht ato veti nuk gjenden tek asnjë njeri asnjëherë...”

manifestime të neglizhencës në edukatën e fëmijëve rreth botëkuptimit të fjalës *bashkëshortësi* dhe disa parafytyrime të gabuara të grave rreth martesës dhe nevojave të saj.

- Te disa njerëz ekziston një bindje, që martesë nuk ka rëndësi të madhe dhe nuk është e domosdoshme, derisa vajza është e lumtur, e respektuar, e qetë në shtëpinë e babasë së saj, dhe nuk i mungon as sendi më i vogël. Shpërndarja e këtij besimi në mesin e vajzave vjen si pasojë e dëgjimit të problemeve martesore, dhe ankesave të disa grave të divorcuara, prej të cilave disa janë të vërteta, por në shumicën e rasteve janë gënjeshtër, vetëm e vetëm ta mbrojnë veten prej fjalëve të njerëzve. Ky është edhe shkaku i largimit të vajzave prej idesë së martesës, posaçërisht kur është e re dhe me përvojë të pakët, dhe kur mbështetet në edukatën e shoqeve të saja dhe mjeteve të informimit, duke mos e harruar këtu edhe neglizhencën dhe preokupimin e prindit, që ta përmirësojë atë ideologji të gabuar.

- Disa prej vajzave martesën e njohin thjesht vetëm si ceremoni dhe protokoll. Kur përmendet martesë ajo fillon të flasë vetëm për anën materiale që nuk vlen aspak. E neglizhon dhe e harron, dhe askush s'i tërheq vërejtjen asaj për anën e tjera martesore, që padyshim se gjurmët e saja janë më të mëdha në jetën bashkëshortore,

si p.sh.: menaxhimi dhe administrimi i punëve shtëpiake, mënyra e sjelljes me burrin dhe me familjen e tij, mënyra e veprimit të saj në fazën e re që do të ballafaqohet me të. Disa prej vajzave pasi martohen nuk dëshirojnë të binden se gjendja e tyre është ndryshuar, dhe se nuk është më *vajza e babit*, por është bërë bashkëshorte, e cila është përgjegjëse për veprat dhe sjelljet e saj para njerëzve. Njerëzit në shumicën e rasteve i pranojnë dhe i falin disa vepra dhe gabime prej një vajze të pamartuar, në krahasim me një grua të martuar, ku nuk pranohen veprat dhe gabimet e saj aq lehtë, po sikur ta kishte kaluar edhe vetëm një natë si e martuar.

- Shumica e vajzave në ëndrrat e tyre e imagjinojnë bashkëshortin me cilësi dhe veti të plota, që realisht ato veti nuk gjenden tek asnjë njeri asnjëherë. Prandaj lindin edhe problemet kur vjen një djalosh e kërkon dorën e saj dhe ajo e refuzon për shkak se nuk i përngjan princit të ëndrrave të saj. Ndonjërin e refuzon se është i varfër, tjetrin se është i vogël, apo hundën e ka të madhe, apo është i trashë, e kështu me radhë, kurse prindërit e saj për fat të keq e mbështesin plotësisht dhe e respektojnë lirinë e të drejtës së saj në zgjedhjen e burrit të vet. Në vazhdim ajo e humb shansin për t'u martuar me një burrë, i cili e respekton, e nderon, ia mbron dynjanë dhe fenë e saj, ia plotëson të drejtat e saj, dhe ia ngre pozitën asaj tek Allahu.

- Në disa shtëpi është nëna ajo, e cila merr përgjegjësinë e plotë për përkujdesjen e shtëpisë. Ajo gatuan, ajo pastron, ajo ia drejton dhe ia rregullon vajzës shtratin, ia lan rrobat, dhe çka është më e keqja nuk e mëson vajzën e tyre për përgjegjësitë e saj ndaj shoqërisë, si pjesëmarrjet, urimet, ngushëllimet, lidhjet farefisnore etj. Prandaj shumë shpejt pasi ajo martohet ballafaqohet me një problem shumë të madh. Ajo

detyrohet t'i kryejë personalisht të gjitha këto detyra, në shtëpi apo jashtë saj, e pastaj ndoshta edhe lind fëmijë, e nuk di se si ta ushqejë, e ta pastrojë, dhe në fund detyrohet që ta thërrasë nënën e saj që ta ndihmojë dhe të plotësojë rolin e saj në përgjegjësisë e përkujdesjes së shtëpisë së vajzës së vet. Kurse për sa i përket burrave të këtyre vajzave në kësaj rastesh hasim burra që bëjnë durim me gratë e tyre, dhe hasim burra që nuk bëjnë durim, dhe fillojnë problemet mes tyre, ku mundet të përfundojnë edhe me ndarje mes bashkëshortëve, e në fund ata që akuzohen janë prindërit, e në veçanti nëna.

- Janë disa vajza, të cilat besojnë se martesë është ëndërr e ëmbël, fillimi i një tregimi për një dashuri të bukur, dhe se ajo është porta e lumturisë, duke mos u munduar aspak për arritjen e saj, dhe se martesë është vetëm aventurë, kënaqësi, dashuri, rehati etj. Të gjitha këto premtime janë fjalë dhe ide, që i ngulitin djemtë në mendjen e vajzave, dhe mosreagimi i prindërve në përmirësimin e këtyre ideve të gabuara bëhet shkaktar i problemeve bashkëshortore. Kur ajo vajzë e porsamartuar ballafaqohet me realitetin, ajo sheh se krejt ato premtime ishin ëndrra dhe iluzione.

Pra, martesë është një përgjegjësi e vazhdueshme në jetë dhe nuk është vetëm kënaqësi, por është edhe vepër dhe këmbëngulje në arritjen e lumturisë, e cila ndoshta dallon prej asaj që e ka parafytyruar një vajzë, mirëpo lumturia në martesë ka shumë forma dhe lloje të tjera plotësisht të kundërta me atë që e parafytyrojnë vajzat në mendjen e tyre. ■

Nga arabishtja: Irfan JAHIU

INTERVISTË ME AKTORIN SHQIPTAR NGA SHKUPI, ISMET RAMADANI

“JETA PA ISLAM ËSHTË BARAZI ME ZERO”

BISEDOI ME TË: OMER BERISHA

Ismet Ramadani është aktor i diplomuar, momentalisht i punësuar në fakultetin e artit dramatik në Shkup si asistent i aktrimit njëkohësisht është duke magjistruar në atë drejtim, si dhe punon edhe me projekte të tjera private kohë pas kohe. Ne bëmë një bisedë të mirë me të, nga e cila po ju sjellim:

Albislam: Thonë se Ismeti sot bën një jetë ndryshe në dallim nga ajo që ka bërë më



herët, ku është dallimi? Si dhe, ku është shkaku i atij dallimi?

Ramadani: Po, është e vërtetë se ka dallim meqë tani jetoj me Islamin. Më herët kjo nuk ka qenë kështu, kurse tani mundohem që t'i përmbahem rregullave dhe detyrave islame. Çdo ditë e imja tani nuk është monotone, pasi jam i angazhuar me namaz, me dhikër dhe me lexim Kurani. Kjo më bën të ndjehem krenar që jam musliman dhe që jam në mesin e njerëzve që i bien në sexhde Allahut. Tash e shoh se sa i

paditur kam qenë më parë, deri kur erdhi koha ta kuptoj, se pa Islam në këtë jetë gjithçka është barazi me zero.

Albislam: *Një artist i penduar sa mund t'i kontribuojë kauzës Islame?*

Ramadani: Po unë mendoj se – edhe pse nuk e ndjej veten të veçantë të qenit aktor, por e ndjej veten krenar dhe privilegj që jam musliman – ky kontribut mund të jetë në shumë mënyra. Unë deri tani kam përgatitur disa monologë, të cilat i kemi shfaqur në muajin e bekuar të Ramazanit. Po shpresoj dhe kemi plane me disa kolegë të mi të bëjmë edhe ndonjë projekt më të madh.

Albislam: *A mbani kontakt me artistë të tjerë, që i janë kthyer Islamit me përkushtim? Çfarë do t'i këshillonit kolegët e tjerë tuaj?*

Ramadani: Të them të vërtetën nuk kam kontakte me shumë, pasi ndoshta edhe nuk jemi takuar deri më tani. Shpresoj se do të ndodhë, por këtu kam kontakt me njerëz, të cilët i përkasin arteve të tjera dhe me të cilët tani vendtakimi ynë nuk janë kafeteritë, por xhamitë. Ndërsa kolegëve të tjerë dhe gjithë njerëzve u sugjeroj të pendohen dhe t'i bien në sexhde Allahut, në qoftë se duan të jenë të lumtur në këtë botë dhe në ahiret. Çelësi i gjithë kësaj është namazi.

Albislam: *Spektaklet e ndryshme që organizohen nëpër medie, qofshin muzikore etj., që kanë në program zbulimin e talenteve apo karaktereve, si po ndikojnë në jetët dhe formimin e rinisë?*

Ramadani: T'ju them të drejtën kanë shkuar aq larg, saqë janë bërë pjesë e jetës këto spektakle dhe njerëzit kanë filluar të mendojnë në atë mënyrë dhe ta imitojnë atë lloj jete, e cila padyshim është degjeneruese.

Albislam: *Mosangazhimin e madh të shqiptarëve të Maqedonisë në këtë drejtim (muzikë, spektakle, filma) shumë njerëz e interpretojnë si prapambetje, izolim etj., cili*

“Kur kam streset apo problemet më të mëdha unë mezi pres që të vijë koha e namazit dhe të qetësohem...”

është mendimi juaj?

Ramadani: Po mirë, ndoshta tek ne janë më pak të pranishme, por unë nuk ndjej, as prapambetje, as izolim, por ndoshta është një vetëdije më e lartë për sendet e këqija, që na rrethojnë dhe na ngulfasin. Izolim është kur je pjesë e këtyre mashtrimeve.

Albislam: *Nëse një artist largohet nga një haram, me çfarë do ta zëvendësonte atë zbrazëti?*

Ramadani: Po unë thashë, nuk kam zbrazëti, sepse jam i angazhuar me namaz, me dhikër dhe me lexim Kurani, të cilin e kam mësuar para disa kohësh dhe mendoj se kjo është mënyra më e mirë për t'u mbrojtur prej haramit dhe për të qenë i lumtur.

Albislam: *Ku e gjeni rehatinë dhe kënaqësinë më të madhe?*

Ramadani: Është interesante, se kur kam streset apo problemet më të mëdha unë mezi pres që të vijë koha e namazit dhe të qetësohem. Pra, me namaz unë gjej qetësinë dhe ai më bën të ndjehem krenar dhe më i fortë në rrugën e Allahut. E lus Allahun, që të gjithë të rinjtë tanë t'i udhëzojë në rrugën e drejtë dhe të vetme, që quhet Islam.

Albislam: *Allahu ju shpërbleftë për këtë bisedë të këndshme.*

Ramadani: Ju falënderoj për këtë intervistë dhe lus Allahun që të shërbejë për dobi kjo bisedë e jona, selam alejkum.

Albislam: *ue alejkum selam. ■*

INTERVISTË ME AKTORIN E NJOHUR NGA KOSOVA, NASER RAFUNA



“DO TË PENDOHESHA SIKUR TË MOS JEM I PENDUAR”

BISEDOI ME TË: OMER BERISHA

Albislam: E lus Allahun t’ju japë sukses në ato punë me të cilat Ai është i kënaqur dhe t’ju bëjë shembull të së mirës. Ne deshëm të bëjmë një bisedë nga e cila shpresoj se do të kënaqen edhe lexuesit tanë. Na thoni në fillim kush është Naser Rafuna dhe me çfarë merret ai?

Rafuna: Jam i lindur në Prishtinë. Me profesion aktor. Momentalisht luaj në serialin ‘Kafeneja Jonë’, që e prodhon CMB për RTK-në. Jam asistent profesor i profesorit Enver Petrovci në Akademinë e Arteve dhe po ashtu jam edhe student i studimeve Master në Fakultetin e Arteve në Prishtinë.

Albislam: Çfarë libra lexoni dhe cili është libri që ju ka lënë më shumë përshtypje dhe pse?

Rafuna: Lexoj shumë libra dhe e kam tejkaluar numrin katër shifror të lexuarit të tyre. Ndërsa Libri që të len përshtypje më shumë është padyshim Kurani. Unë para se të lexoj Kuranin kam lexuar mjaft BestSellera të autorëve të ndryshëm të mëdhenj botërorë. Dihet çka është i ardhur nga qielli e çka nga imagjinata dhe inspirimi, duke pasur motiv vetëm perceptimin, imagjinatën dhe motivin autori.

Albislam: A mendon se të rinjtë shqiptarë i ka kapur “epidemia” e vrapimit pas famës me çdo kusht? A pajtoheni se shumë prej tyre nëpërkëmbin shumë parime, sidomos

ato fetare islame, me qëllim që të realizojnë synimet e tyre?

Rafuna: Frika nga vdekja, inferioriteti, kompleksi i dukjes apo pamjes së jashtme, si dhe kulturës, edukatës dhe bontonit, rinia jonë dhe një pjesë e madhe e saj vetëm e pasojnë pa pasur argument, pa arsyetim dhe logjikë rrugën e ardhmërisë, vendosmërisë dhe vendimmarrjes. Në këtë formë ka të bëjë mosedukimi familjar, sepse mendoj që kompleksi i cili trashëgohet e sjell këtë pasojë. Fama jepet dhuratë prej Zotit, ndërsa dallon karriera. Nuk është problemi, se nëse njeriu nuk di apo është i paditur ose injorant, problemi qëndron në faktin se ka shumë sish, të cilët nuk dëshirojnë të dinë. Njerëzit nuk mund t'i nëpërkëmbin parimet fetare të dhëna si dhuratë nga Zoti, por ata mund ta nëpërkëmbin veten, duke mos e vërejtur këtë gjë, nga arsyeja e shpresave të kota. Unë i njoh jobesimtarët, të cilët irritohen nëse flitet ndonjëherë tema për Zotin, fenë dhe rrugën e drejtë. Normal, flas për Fenë Islame, ngase besoj se është e vetmja fe e pranuar dhe e dhuruar nga Zoti, të tjerat janë njerëzore, epshore dhe pasuese me përplot kontradikta që logjika nuk i pranon. Unë jam musliman, sepse edhe po të isha i ndonjë feje tjetër shpresoj se do të isha bërë musliman nga një arsye: sepse mendoj si duhet e jo si dua. Mendjemadhësia, lakmia dhe xhelozia po e shkatërron rininë dhe popullin tonë.

Albislam: *Spektaklet e ndryshme që organizohen nëpër medie, qofshin muzikore etj., që kanë në program zbulimin e talenteve apo karaktereve, si po ndikojnë*

“...Nëse Zoti nuk më fal, unë jam i humbur, të tjerat kanë zgjidhje...”

“...Unë i njoh jobesimtarët, të cilët irritohen nëse flitet ndonjëherë tema për Zotin, fenë dhe rrugën e drejtë...”

në jetët dhe formimin e rinisë?

Rafuna: Është ide koti. Sepse qëllimi nuk është rinia, por përfitimi apo fama e organizatorëve, apo e producentëve. Dashuria e të qenit në qendër të vëmendjes kalon shpejt dhe krejt çka mbetet është puna e madhe me vullnet të mirë.

Albislam: *Kush është vizioni i rinisë tonë?*

Rafuna: Rinia jonë s'ka vizion.

Albislam: *A beson se xhamitë (hoxhallarët) mund të japin kontributin e tyre në këtë drejtim?*

Rafuna: Çdo njeri me qëllim të mirë mund të japë një kontribut të mirë. Hoxhallarë për mua janë ata që e mbajnë çallmën jo vetëm në xhami. Edhe jashtë saj e kanë krenarinë.

Albislam: *Çfarë është ajo për të cilën do të pendoheshit?*

Rafuna: Të mos pendohem kurrë. Do të pendohesha sikur të mos jem i penduar. Nëse Zoti nuk më fal, unë jam i humbur, të tjerat kanë zgjidhje. Shpresojmë në falje. Kush mëshiron, mëshirohet. Kush fal, falet. Kush falet, falet.

Albislam: *Si e paramendoni ardhmërinë e shqiptarisë?*

Rafuna: Shqiptarët të bashkuar në një vend, një shtet, një komb, përndryshe kot është tjetër gjë, ose kështu siç jemi. Duhet të jemi një vend i madh. Një Shqipëri.

NJERËZ TË MËDHENJ RRALLË LINDIN

Abdullah ibën Omeri transmeton ta ketë dëgjuar të Dërguarin e Allahut, *sal-lallahu alejhi ue selem*, duke thënë: “Njerëzit i ngajjnë grumbullit të deveve, ku në mesin e njëqind prej tyre është e vështirë të gesh një, të cilën do ta shfrytëzoje për udhëtim.”

SHKRUAN: LULZIM SUSURI

Zinxhiri i hadithit: Këtë hadith e transmeton Abdullah ibën Omeri, kurse në librat e tyre e shënojnë Buhariu nr. 6498 dhe Muslimi nr. 2547.

Komenti i hadithit: Në këtë hadith Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, përmes këtij krahasimi tregon llojet e njerëzve, të cilët në bartjen e përgjegjësi i ngjasojnë deveve. Devetë parimisht ndahen në dy lloje: aso që shërbejnë vetëm për bartje dhe transport mallrash dhe lloji i dytë ato që bartin edhe njerëz dhe shërbejnë për udhëtime të gjata mbi to, të cilat njëherësh edhe i nënshtrohen

çdo njeriu duke i respektuar urdhrat e tij.

Vështirësia e gjetjes së deveve, e cila shërben për çdo lloj pune është e madhe, bile trajnimi i tyre është edhe më i vështirë, ku mu për këtë shkak njerëzit zakonisht i ikin trajnimit të tyre dhe mundohen që të gjejnë apo blejnë deve të ushtruara paraprakisht, gjë të cilën e gjejnë me vështirësi. Vështirësi të tilla njerëzit kanë edhe në gjetjen e shokëve të tyre, ku në mesin e njëqind njerëzve është zor të gesh një të tillë, të cilin do ta merrje për shok besnik dhe do të ishte ndihmës i shokut të vet në bartjen e përgjegjësi, udhëtimeve të gjata, telasheve të mëdha etj.



Në komentin e këtij hadithi nuk dua të lë pa përmendur fjalët e shejh Abdurrahman ibën Nasir Sadiut, i cili gjatë komentit të tij thotë: “Ky hadith përmbledh në vetvete një lajm të saktë nga njëra anë dhe një udhëzim të dobishëm nga ana tjetër.

Sa i përket lajmit në të Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, e tregon qartë, se tek shumica e njerëzve në këtë botë mbretëron mangësia, ndërsa njerëzit e plotë - apo ata që janë afër përsosmërisë personale - janë pak, ashtu si shembulli i deveve, të cilat i sheh njëqind në grumbull dhe me të vërtetë duken shumë, mirëpo nëse kërkon deve të dobishme që do ta shfrytëzoje për transport mallrash apo bartje njerëzish, për shkuarje dhe vajtje të tilla gjen shumë pak në mesin e gjithë atyre.

Njësoj është edhe shembulli i njerëzve, të cilët në numër janë shumë, por vështirë e ke të zgjedhësh një, i cili t'ia vlejë për t'i mësuar të tjerët, për fetva, imam, udhëheqës i të mëdhenjve apo të vegjëlve, apo punë të tjera të rëndësishme. E tërë kjo për faktin se njeriu është zullumqar dhe injorant, dy veti këto të cilat janë shkaktare, që ai të mbetet i mangët dhe i pakompletuar. Kjo kishte të bëjë me lajmin.

Për sa i përket udhëzimit profetik në këtë hadith ai tregon, se i tërë umeti duhet të vrapojnë, të mundohen dhe të përpiqen që të krijojnë njerëz dhe kuadro, të cilët do të merrnin përsipër çdo vështirësi dhe do të bartnin mbi supe çdo përgjegjësi. Këtë fakt që përmendëm e vërteton edhe fjala e Allahut Fuqiplotë, i Cili thotë: **“Prej çdo bashkësie, një grup të mbetet mbrapa, që të thellohet në mësimin e fesë dhe kështu të këshillojë popullin e vet, mbasi të kthehet nga lufta, që t'i frikësohet Allahut.”** (Teube, 122), në këtë ajet paraprakisht urdhëroi që një grup i mjaftueshëm të merret me punët e

“...Vështirësi të tilla njerëzit kanë edhe në gjetjen e shokëve të tyre, ku në mesin e njëqind njerëzve është zor të gjejsh një të tillë, të cilin do ta merrje për shok besnik ...”

luftës në rrugë të Allahut, kurse grupi tjetër të merret me dituri e kështu të ndihmohen mes vete për të mira.

Punët në përgjithësi si ato të dynjasë, ashtu edhe ato të ahiretit kanë nevojë për njerëz që t'i kryejnë ashtu si duhet dhe bota në përgjithësi nuk mund të ketë dobi ndryshe, veçse duke i kryer të dy llojet e punëve, por të gjitha këto punë me llojet e veta kanë nevojë për njerëz, dhe assesi nuk mund të dalin me sukses nëse përgjegjësit e tyre nuk janë burra të denjë të lëmenjve përkatës. Në fund them se çështjet si ato fetare apo të kësaj bote kanë nevojë për njerëz të denjë, që do të ishin të suksesshëm në marrjen dhe kryerjen e përgjegjësiave të tilla, prandaj është obligim që të hulumtojmë për njerëz, të cilët do të ishin të denjë për bartjen e amaneteve të tilla mbi supet e tyre.”¹

Disa dijetarë të tjerë këtë hadith e komentojnë me faktin se ai përmban në vetvete dy kuptime:

I pari: të gjithë njerëzit në Islam paraprakisht janë njësoj dhe askush prej tyre nuk ka përparësi ndaj tjetrit. Për sa i përket dispozitave të sheriatit në Islam janë të barabartë, si pasaniku ashtu edhe fukaraja, ai me famë apo ai pa famë, i shkolluari dhe

¹ Marrë nga libri: “Behxhet kulubil ebrar ue kurret ujunil ahjar fi sherhi xhevamiil ahbar” të Abdurrahman ibën Nasir Sadi.

inJORanti. Pra, kjo barazi është në aspektin e kryerjes së detyrimeve fetare dhe në aspektin e shpërblimit dhe të ndëshkimit, pra ai që bën faj ai ndëshkohet, duke mos i interesuar fesë, se personi në fjalë është pasanik apo i varfër. Pra, ata janë të gjithë njësoj sikurse devetë, që janë parimisht të njëjta me njëra-tjetrën.

Kuptimi i **dytë** sipas këtij mendimi është fakti se shumica e njerëzve në origjinën e tyre janë të mangët, kurse njerëzit e përsosur (edhe pse përsosmëria absolute i takon Allahut të Vetëm) janë shumë pak, në njëqind vështirë se mund ta gjesh një prej tyre. Kësaj gjëje i përgjigjet fjala e Allahut: **“Mirëpo shumica e njerëzve nuk e dinë.”** (Araf, 187). Ndërsa imam Buhariu këtë hadith e ka futur në kapitullin e **“Ngritjes së amanetit nga fytyra e tokës”**, ku na jep të kuptojmë, se shumica e njerëzve nuk do të jenë në gjendje ta bartin amanetin, apo përgjegjësinë që u jepet dhe kështu me njerëz të tillë sipas tij nuk duhet shoqëruar, mu ashtu siç nuk është e lejuar që njeriu t'i hipë devesë e cila nuk është e trajnuar për bartje dhe transport njerëzish.

Dobi të nxjerra nga hadithi:

1- Është detyrim fetar për çdo institucion, apo edukator, që nxënësit tek të cilët vërehen cilësi të veçanta pozitive t'i kultivojnë ato veti dhe këta nxënës t'i stimulojnë që të ecin përpara e jo t'i lënë anash e kështu të vdesin vetitë e tyre të mira. Kjo për arsye se njerëzit e dobishëm prej të cilëve pritët shumë në të ardhmen zakonisht janë pak në numër, prandaj duhen përkrahur me çdo kusht ata, duke iu ofruar të gjitha mundësitë për përparimin e mëtejshëm. Profeti, *sal-lallahu alejhi ue selem*, kur pa veti të dalluara tek Omer ibën Hatabi dhe tek Ebu Xhehli deshi që t'i shfrytëzonte cilësitë e tyre për të mirën e Islamit, prandaj edhe iu lut Allahut, që ta udhëzonte njërin prej tyre. (Shënon Ahmed, nr. 5363 dhe Tirmidhiu, nr.

“...Këtë vërejtje duhet ta kenë parasysh shumë prindër, të cilët mendojnë se fëmijët e tyre janë njësoj në aftësi dhe bartjen e përgjegjësisë...”

5681)

2-Prijësit në përgjithësi dhe thirrësit islam në veçanti, kur ta kuptojnë domethënien e këtij hadithi ata duhet ta kenë pastaj parasysh, se njerëzit janë të mangët dhe nuk kanë fuqi të gjithë që të jenë njësoj, kështu që ai duhet t'i ketë parasysh dobësitë e tyre dhe të mos mundohet të presë prej tyre shumë gjëra, apo t'u japë shumë përgjegjësi kjo për vetë faktin, se shumë deve janë deve dhe mund të shërbejnë për bartjen e mallit, por që të bazohesh dhe të presësh transportin e njerëzve prej tyre ato janë pak.

3-Nëse një njeri na habit me arritjet e tij kjo nuk do të thotë, se të gjithë njerëzit janë të tillë d.m.th., të mos mendojmë se sikur ai njeri mund të jenë edhe të tjerët dhe kështu të obligohen të gjithë me gjërat që ka marrë përsipër një person i vetëm. Kjo për arsye se edhe pse një njeri është i aftë t'ia dalë deri në fund një detyre të vështirë, nuk do të thotë se të gjithë mund ta bëjnë një gjë të tillë dhe të gjithë të obligohen njësoj. Këtë vërejtje duhet ta kenë parasysh shumë prindër, të cilët mendojnë se fëmijët e tyre janë njësoj në aftësi dhe bartjen e përgjegjësisë, ku i sheh ata se bazohen në aftësitë e njerit prej fëmijëve dhe pastaj mundohen që t'i obligojnë të gjithë me të njëjtën përgjegjësi, apo e sheh se njëri prej tyre është i aftë në një zanat të caktuar e duke u bazuar aty mundohet që të gjithë të tjerët t'i fokusojnë në të njëjtin zanat, duke mos pasur parasysh, se

ndoshta i dyti është i aftë për një drejtim tjetër të caktuar e jo për atë që është fëmija i parë.

4-Njerëzit, të cilët dallohen në disa fusha nga të tjerët, këta e kanë obligim që t'i qëndrojnë besnik drejtimit të tyre e të mos dezertojnë nga ajo lëmi, të cilën Allahu ua ka lehtësuar dhe ua ka bërë të mundur që të dallohen në të. E gjitha kjo, për arsye se ndoshta vetëm ai është i dalluar në ato çështje në të tërë vendin e tij dhe kështu duke e lënë profesionin e vet ai i dëmton edhe të tjerët, sepse nuk janë të tërë njerëzit të gatshëm dhe të aftë për të gjitha drejtimet, prandaj secili duhet t'i shërbejë Islamit dhe njerëzve nga këndi i tij në të cilin ai është i aftë ta bëjë atë gjë. Në këtë mënyrë çdonjëri plotëson një boshllëk në shoqëri.

5- Hadithi na jep të kuptojmë, se shumica e njerëzve nuk janë të aftë t'i perceptojnë vetë gjërat dhe në shumicën e rasteve ata i marrin gjërat të gatshme dhe nuk mund t'i analizojnë vetë. Do të veçoja duke përmendur njerëzit që i besojnë çdo lajmi që shërbehet në media dhe nuk janë të aftë t'i shohin vetë gjërat apo t'i analizojnë ato. Ju besojnë dy-tre politikanëve dhe janë të betuar për ta, pa menduar për dështimet e tyre disa vjeçare, apo pa e analizuar mosmbajtjen e premtimeve të tyre, përkundrazi me një premtim të vogël, me dy javë fushatë parazgjedhore i harrojnë të gjitha vështirësitë që kanë hasur deri atë ditë. Prandaj edhe shohim se populli nuk është në gjendje t'i ndryshojë gjërat, sepse janë sikurse devetë, që njëra i udhëheq në udhëtim e të gjitha shkojnë pas saj, pa e ditur se ku po shkojnë.

6- Është obligim i çdo muslimani, i cili e sheh veten se është i aftë në një lëmi, që ta vazhdojë punën e vet e të mos ndalet në atë drejtim, por ta plotësojë atë zbrazëti. Këtë vazhdimësi në drejtimin apo profesionin e vet e ka obligim fetar, e sidomos në atë kohë


“Populli nuk është në gjendje t'i ndryshojë gjërat, sepse janë sikurse devetë, që njëra i udhëheq në udhëtim e të gjitha shkojnë pas saj, pa e ditur se ku po shkojnë...”

kur nuk ka njeri tjetër, që mund ta zëvendësojë.

7- Gjithashtu është obligim i popullit, si dhe i udhëheqësve, që pozitën e caktuar dhe punët në përgjithësi t'ua japin njerëzve që i meritojnë dhe janë të aftë për pozitën të tilla, e jo t'i afrojnë njerëzit familjarë apo ata të cilët kanë pasuri dhe i korruptojnë, sepse duke mos iu dhënë pozitën njerëzve të merituar të gjithë humbin dhe vendi mbetet prapa, kurse ata që i kanë përgjegjësi ndarjen e pozitave, nëse janë të padrejtë futen në radhët e mëkatarëve.

8-Kundërshtimet mes njerëzve gjithmonë nuk janë vetëm për shkak të kundërshtimeve psikike, por ka raste kur ata janë në kundërshtim edhe për arsye të mos mundësisë së bartjes së përgjegjësisë. Pra, mund të jenë të barabartë në dije por nuk janë të tillë në aftësitë e vënies në praktikë të asaj që ata kanë mësuar.

9- Të kuptuarit e këtij hadithi na jep mësim, se njeriu duhet të ketë ambicie të larta dhe të inspirohet gjithmonë nga njerëzit e mëdhenj, të cilët kanë arritur të bëjnë diçka në jetë, dhe që janë të pakët në numër, e jo të shikojnë tek të tjerët që janë të dështuar në jetë. Pra, duhet të shikojnë tek njerëzit që janë mbi ata me arritje e jo tek ata që janë nën ta, sepse kjo do t'ia humbte ambiciet dhe nuk do të përparonte asgjë. ■



BUZËQESHJA NË PRAKTIKËN E PROFETIT

. Thonë se buzëqeshja ndikon pozitivisht në gjendjen psikike të qetësisë dhe relaksimit. Sot kur stresi është sëmundje e botës bashkëkohore, buzëqeshjen të cilën na e mëson Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* është një parandalim i përsosur.

SHKRUAN: PRIM. DR. MED. SC. ALI ILJAZI

Falënderimet e panumërta qofshin për Allahun e Madhërishëm, Zotin e botëve! Salavati dhe selami qoftë për robin më të mirë të Allahut, Muhamedin, për familjen e tij të ndershme dhe sahabët fisnikë.

Në këtë numër me lejen e Allahut kemi si qëllim të njihemi me një Sunet (praktikë) të Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* të lënë mjaft pas dore. Kur lexojmë biografinë e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* (sirën) e gjejmë se këtë Sunet, të cilin e quajmë “mjet për përfitimin dhe zbutjen e

zemrës”. Nga jeta e tij, *sal-lallahu alejhi ue selem*, ne e kuptojmë se ai i ka shfrytëzuar të gjithë mjetet e duhura për t’i afruar njerëzit kah feja e Allahut.

Nga këto mjete është edhe një lëvizje... Kjo lëvizje, një Sunet i lënë për të cilin flasim është shumë e lehtë të bëhet. Ky është siç e quajnë atë fjalë pa zë dhe pa shkronja... Nuk zgjat më tepër se një lëvizje syri. Fillon nga buzët, kalon nëpër dyert e syve të tjerë, dhe përfundon në zemrën e atij që i është drejtuar. Ky Sunet është sadaka (lëmoshë) dhe kjo sadaka ka rrjedhur vazhdimisht nga buzët e Pejgamberit tonë të dashur *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Kjo është **buzëqeshja**. Ndoshta tingëllon çuditshëm që buzëqeshja është sadaka, por Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* na paralajmëron: “Mos e mendo si të pavlerë asnjë nga veprat e mira, qoftë edhe të takosh vëllanë tënd me fytyrë të qeshur.” (Hakimi dhe Bejhekiu) Në hadithin tjetër, Muhamedi *sal-lallahu alejhi ue selem* e krahason buzëqeshjen me sadakanë, duke na nxitur që këtë sadaka ta japim gjithnjë: “Buzëqeshja vëllait tënd (musliman) është sadaka.” (Tirmidhiu dhe Ibn Hibani). Se sa vend të madh ka zënë buzëqeshja në jetën e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* na flet imam Buhariu, i cili në Sahihun e tij e ka ndarë një kapitull të veçantë “Mbi buzëqeshjen dhe qeshjen” (Babu tebessum ue dahik).

Buzëqeshja përmendet edhe në Kuran, kur Sulejmani *alejhi selam* buzëqeshi me fjalët e milingonës: “**Deri atëherë kur arritën mbi luginën e milingonave, një milingonë tha: “O ju milingona, hyni në vendet tuaja që të mos u copëtojë Sulejmani dhe ushtria e tij duke mos ju vërejtur”. E ai (Sulejmani) buzëqeshi i gëzuar prej fjalës së saj dhe tha: “Zoti im, më mundëso që t’i falënderoj të mirat Tuaja që m’i dhurove mua dhe prindërve të mi dhe që të bëj vepra**

“...Fillon nga buzët, kalon nëpër dyert e syve të tjerë, dhe përfundon në zemrën e atij që i është drejtuar. Ky Sunet është sadaka ...”

të mira që Ti i pëlqen, e me mëshirën Tënde më fut në mesin e robërve Tuaj të mirë!” (Neml, 18-19).

Buzëqeshja ishte praktikë e përhershme e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*. Buzëqeshje kur takonte sahabët, i priste me buzëqeshje. Buzëqeshje kur shihte njeriun, i cili e mposhte zemërimin e tij. Buzëqeshje kur dikush gabonte, duke përmirësuar gabimin e tij me një buzëqeshje të lehtë.

Themi se e pasojmë Sunetin e tij, ndërsa kur dikush gabon e përmirësojmë me bërkitje, fjalë të vrazhda dhe fytyrë të mrrolur. Le ta dëgjojmë Xheririn *radijallahu anhu*, i cili na tregon siç qëndron në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit: “Asnjëherë nuk më ka parë Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* pasi e kam pranuar Islamin, e të mos më ketë buzëqeshur.”

Me një rast i erdhi një beduin i njohur për nga vrazhdësia e tij natyrale, iu drejtua me fjalë të ashpra, por Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* e priti me butësi dhe buzëqeshje. Beduini i tha: “O Muhamed, urdhëro të më jepet nga pasuria e Allahut që është te ti.” Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* buzëqeshi me këto fjalë të ashpra dhe urdhëroi që t’i jepet bedunit sadakaja. Me këtë veprim ai e zbuti zemrën e bedunit.

Buzëqeshja e tij nuk u zhduk as në momentet e fundit të jetës së tij në këtë botë. Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* u nda me buzëqeshje nga sahabët dhe dynjaja! Enesi *radijallahu anhu* tregon siç

është përshkruar në Sahihun e Buhariut dhe Muslimit: “Ndërsa myslimanët ishin duke falur namazin e sabahut ditën e hënë (ditën kur Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* kaloi në Ahiret), kur Ebu Bekri po udhëhiqte namazin i befasoi Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem*. Ai hoqi perden nga dhoma e Aishes *radijallahu anha*, i shikoi sahabët e renditur në safë dhe buzëqeshi.”

Buzëqeshja, siç e shohim nga rastet e shumta ka qenë praktikë e Muhamedit *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe rrugë për te zemra e njerëzve. Shkriu me të akullin e zemrave të vrazhda, bëri që nga zemrat e ngurta të rrjedhë uji i mëshirës dhe i dhembshurisë. Sot hasim njerëz te të cilët buzëqeshja është e rrallë. Duket sikur i kanë buzët e çimentuara dhe nuk mund t’i hapin. Është e qartë se njeriu ndonjëherë kalon nëpër kriza personale, vështirësi, pakënaqësi dhe sprova. Por që njeriu të tërë jetën ta kalojë i mrrolur, duke cunguar buzëqeshjen e të tjerëve, kjo është larg nga praktika e Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Edhe jomuslimanët sot janë të vetëdijshëm për bukurinë e fshehur në buzëqeshje. Thonë se buzëqeshja ndikon pozitivisht në gjendjen psikike të qetësisë dhe relaksimit. Sot kur stresi është sëmundje e botës bashkëkohore, buzëqeshjen të cilën na e mëson Pejgamberi *sal-lallahu alejhi ue selem* është një parandalim i përsosur. Psikologu Dejl Karnexhi thotë: “Kam kërkuar nga nxënësit e mi të zgjedhin nga një person, që për çdo ditë do ta bëjnë të qeshur gjatë javës. Njëri prej nxënësve ishte tregtar dhe zgjodhi ta bëjë të qesh bashkëshorten e tij, e cila nga ai nuk ishte mësuar të shohë një buzëqeshje. Rezultati pas hulumtimit ka qenë, - siç thotë nxënësi - kam zbuluar një lumturi të re të cilën nuk e kam shijuar me vite. Kjo më ka nxitur të buzëqesh me gjithë ata që bie në

“...Sot hasim njerëz te të cilët buzëqeshja është e rrallë. Duket sikur i kanë buzët e çimentuara dhe nuk mund t’i hapin...”

kontakt. Njerëzit për shkak të buzëqeshjes filluan të më nderojnë. Kam ndier se jeta më është bërë më e bukur, më e shkëlqyer dhe fitimi im në tregti më është rritur për shkak të buzëqeshjes.”

Nëse jomuslimanët preferojnë buzëqeshjen, atëherë ne muslimanët e kemi poentën më tepër, për shkak se duke e praktikuar vazhdimisht buzëqeshjen - pasojmë Sunetin e Pejgamberit tonë *sal-lallahu alejhi ue selem*.

Në fund të mos harrojmë se:

- Buzëqeshja zgjat një moment, por të tjerëve mund t’u mbetet si kujtim i bukur deri në fund të jetës, dhe përkujtim për ne për të mirë pas vdekjes sonë.

- Askush nuk mund të thotë, se është aq i varfër, saqë mos t’u ndajë të tjerëve buzëqeshjen.

- Askush nuk mund të thotë se është aq i pasur, saqë buzëqeshja nuk i nevojitet.

- Buzëqeshja është sadaka, e cila nuk do ta varfërojë atë që e jep, por mund ta pasurojë atë që i jepet.

- Buzëqeshja është fjalë pa zë dhe shkronja, por tek Allahu vlen si lëmoshë e dhënë.

- Buzëqeshja është Sunet i Pejgamberit *sal-lallahu alejhi ue selem* dhe përveç shpërblimit për sadakanë e dhënë me buzëqeshje, kemi edhe shpërblimin për pasimin e Sunetit të Pejgamberit tonë të dashur *sal-lallahu alejhi ue selem*. ■



A LEJOHET NGRITJA NË KËMBË PËR NJERËZIT?

PËRGJIGJE NGA: AGIM BEKIRI

Falënderimi i takon Allahut, lavdërimi dhe paqja e Tij qofshin mbi të Dërguarin si mëshirë për botët: Çështja e ngritjes në këmbë për njerëzit është një problematikë rreth së cilës është diskutuar shumë. Para se të futemi në thelbin e kësaj çështjeje duhet të kemi parasysh dy çështje:

E para: në çështjet e paprera (ixhtihadije) s'ka vend mohimi i ndonjërit option në kuptimin që kur një çështje mbështetet në argument, dijetarët nuk bien në ujdi kurse, e vërteta nuk është e qartë si dielli, në këtë rast kërkuesi i diturisë duhet ta përmend

rezultatit, aty ku arrin kuptimi i tij me një kundërpërgjigje shkencore kundërshtarëve dhe me këtë mjaftohet, ngase po të fillojë t'ia mohojë kuptimet kundërshtarit do të dalë një tjetër që do t'ia mohojë kuptimet atij dhe kështu do të futet në një labirint, do angazhohet me të në dëm të gjërave të dobishme, si dhe hutohen njerëzit e rëndomtë.

E dyta: ne jemi të detyruar të kemi parasysh gjithnjë rregullat e Sheriatit:

Kur jemi para dy zgjedhjeve të dëmshme, veprohet ajo dëmi i së cilës është më i vogël.

Largimi i dëmit ka përparësi ndaj përfitimit të një dobie.

Në këtë rubrikë mirëpresim të gjitha pyetjet e juaja, ndërsa ato më interesante do të botohen.
Pyetjet mund t'i dërgoni në albislam@gmail.com

Për sa i përket çështjes tonë dijetarët e hershëm dhe ata bashkëkohorë kanë një mospajtim rreth ngritjes në këmbë për njeriun që na vjen, është e lejuar apo e ndaluar, është e lejuar për disa njerëz dhe ndalohet për disa të tjerë e kështu me radhë. Para se të futemi në këtë mospajtim duhet të përkufizojmë pikën e mospajtimit, prandaj themi: ngritja në këmbë është shumë llojesh:

Qëndrimi në këmbë për njeriun që është ulur si për shembull njerëzit që u qëndrojnë në këmbë mbretërve dhe diktatorëve. Kjo vepër është haram, ngase ndalesa e Sheriatit për të është e drejtpërdrejtë dhe e qartë. Xhabiri, *radjallahu anhu*, na përcjell: “I Dërguari i Allahut ishte i sëmure prandaj na priu në namaz ulur. Ebu Bekri përcillte tekbirot për të dëgjuar (ata prapa) kurse ai (i Dërguari) na bëri me shenjë që të uleshim dhe ne u ulëm. U falëm me të ulur dhe kur dha selam na tha: *Pak më parë gati sa nuk vepruat si persianët dhe romakët, të cilët u qëndrojnë në këmbë mbretërve të tyre, ju mos e bëni një vepër të tillë...*”¹ Përfundim bëhet kur të qëndruarit në këmbë është për ndonjë nevojë siç e thekson Ibën Muflihi: “Ngritja në këmbë për ndonjë dobi apo nevojë siç veproi Makil ibën Jesari, i cili u ngrit për të larguar një degë nga koka e të Dërguarit, ndërsa njerëzit lidhnin besën me të², si dhe ngritja e Ebu Bekrit në këmbë për të mbrojtur të Dërguarin nga dielli, është një vepër e preferuar”.

Ngritja në këmbë për të shprehur përrurime apo ngushëllime: Kjo lejohet, sepse i Dërguari e pranoi ngritjen e Talha ibën Ubejdullahit në këmbë për Kab ibën Malikun për t'i përruruar pranimin e pendimit: “Kabi tha: Hyra në xhami dhe pashë të Dërguarin tek po rrinte ulur, përreth tij kishte njerëz. U ngrit Talha ibën Ubejdullahu dhe me vrap

“...Ngritja e fëmijës për të atin, bashkëshortja për bashkëshortin dhe anasjelltas: kjo vepër lejohet...”

m'u afrua, më dha dorën dhe më përuroi. Pasha Allahun, nuk u ngrit tjetërkush prej muhaxhirëve pos tij. Kabi nuk ia harronte këtë të mirë Talhës.” Këtë vendim e merr edhe ngritja në këmbë për të shprehur ngushëllime, meqë lejohëshka për shprehjen e gëzimit, atëherë për të shprehur keqardhje edhe më parë do lejohej⁴, Allahu e di më mirë.

Ngritja në këmbë për t'i ndihmuar atij që ka nevojë: kjo ngritje është e preferuar, duke u mbështetur në hadithin e transmetuar nga Aishja, *radjallahu anha*, për rastin e Beni Kurejdhasë: “Ebu Seidi tha: kur u shfaq – është fjala për Sad ibën Muadhin – para tyre, i Dërguari uu tha: *Ngrihuni në këmbë zotërisë suaj dhe zbriteni*. Omeri tha: zotëria jonë është Allahu i madhëruar! U tha sërish: *Zbriteni! Ata e zbritën*.”⁵ Ky rast na qartëson se urdhri ishte për t'i ndihmuar Sadit, ngase ai ishte lënduar Ditën e Hendekut, prandaj themi se preferohet ngritja në këmbë për ta ndihmuar atë që ka nevojë. Sikur ngritja të mos ishte për këtë që themi nuk do t'i veçonte me urdhër ensarët. Ibën Haxhaxhi thotë: Sikur ngritja në këmbë për Sadin të ishte për nderim e mirësjellje i Dërguari do të ishte i pari që do bënte një hap të tillë, do të urdhëronte shokët më të vjetër, mirëpo pasi nuk i urdhëroi, nuk e bëri vetë e as të tjerët kjo tregon se urdhri për t'u ngritur në këmbë për ndonjë qëllim tjetër është çështje e diskutueshme. Pra, ngritja ishte për ta zbritur nga kafsha, sepse ishte i lënduar...”⁶.

¹ Muslimi: 1/176.

² El-Adab: 1/460.

³ Muslimi.

⁴ Ahkamu Selam.

⁵ El-Fet-h: 11/51, Ibën Haxheri thotë: zinxhiri është i saktë.

⁶ Med-hal: 1/159.

Ngritja e fëmijës për të atin, bashkëshortja për bashkëshortin dhe anasjelltas: kjo vepër lejohet. Argument për këtë është hadithi i Aishes, *radjallahu anha*, e cila duke treguar rastin e shpifjes që iu bë tha: “Më tha nëna ime: Ngriju në këmbë të Dërguarit! I thashë: Pasha Allahun, nuk i ngrihem. Unë falënderoj vetëm Allahun e Madhëruar.”⁷ I Dërguari pranoi sjelljen e nënës së Aishes për këto fjalë, po gjithashtu mësohet edhe për ngritjen në këmbë për përrurim siç u përmend më lartë. Gjithashtu Aishja thotë: “S’kam parë ndonjë që i ngjante më shumë të Dërguarit nga pamja dhe sjellja – Haseni shtoi: nga fjalët dhe bisedat –se sa Fatimja, *radjallahu anha*. Kur shkante tek ai, i Dërguari i ngrihej asaj në këmbë, e merrte për dore, e puthte dhe e ulte në vendin e tij. E kur ai shkante tek ajo, Fatimja ngrihej, e merrte për dore, e puthte dhe e ulte në vendin e saj.”⁸ Në këtë hadith mësojmë, se lejohet fëmija të ngrihet në këmbë për prindin dhe anasjelltas. Në kuptimin e prindit përfshihet babai, nëna, xhaxhai, daja, tezja, Allahu e di më mirë. Imam Maliku kur u pyet për gruan, e cila e nderon së tepërmi burrin e saj, duke e pritur, duke ia hequr rrobat dhe qëndron në këmbë derisa ai të ulet? U përgjigj: Për sa i përket pritjes nuk prish punë, mirëpo të qëndrojnë në këmbë derisa ai të ulet, nuk bën, sepse kjo është praktikë e diktatorëve. Omer ibën Abdulazizi e mohonte një sjellje të tillë.⁹

Ngritja në këmbë për arritjen e udhëtarit nga rruga: Kjo vepër lejohet, ngase sahabët kur takoheshin pas udhëtimeve përqafoheshin. Ibën Muflihi thotë: Përqaqimi nuk bëhet përpos në këmbë.¹⁰ Muthenaja pyeti Ahmed ibën Hanbelin: Çfarë mendon për përqaqimin? A ngrihet ndonjëri për dikë

“...Nuk ngrihet askush për askënd, mirëpo nëse e sheh se vjen prej udhëtimit, nuk prish punë...”

për ta përshëndetur? U përgjigj: Nuk ngrihet askush për askënd, mirëpo nëse e sheh se vjen prej udhëtimit, nuk prish punë, nëse është fetar, e do për hir të Allahut, shpresoj të mos ketë problem, duke u mbështetur në hadithin e Xhaferit, ku thuhet se i Dërguari e përqafoi dhe e puthti në ballë.

Ngritja në këmbë për të pritur mysafirët: nuk prish punë. Forma e këtij veprimi është të ngrihet ndonjëri për të pritur dikë, që do vijë tek ai. Ibën Kajimi hadithin e ngritjes së Fatimes për të Dërguarin dhe hadithet e tjera i konsideron si argument për këtë ngritje, kështu duke bërë një bashkim mes haditheve, që e lejojnë një vepër të tillë dhe haditheve që ndalojnë: “në hadithet e lartpërmendura¹¹ ngritja është me shkas, pra, për atë që vjen d.m.th. për ta takuar e jo për të qëndruar për të në këmbë, siç mësohet në hadithin e ngritjes së Fatimes në këmbë. E qortuar është të qëndrosh në këmbë për dikë e jo të ngrihesh për ta pritur kur vjen. Në këtë mënyrë harmonizohen të gjitha hadithet, Allahu e di më mirë.¹²

Ngritja në këmbë kur e sheh ndonjërin: kur njerëzit janë në një ndeje dhe dikush hyn tek ata, njerëzit ngrihen dhe e përshëndesin. Rreth kësaj forme është debatuar shumë dhe mendimi më i saktë, si duket, është ndalimi qoftë haram apo mekruh, sepse ka hadithe të shumta e të qarta që e ndalojnë një ngritje të tillë. Nga ana tjetër hadithet e kundërta, ose

⁷ Buhariu.

⁸ Ebu Davudi, Nesaiu, Ibën Muflihi thotë: hadithi është sahih.

⁹ Fet-hul Bari 51/11.

¹⁰ El-Adab: 1/459.

¹¹ Fjala është për ato që e lejojnë ngritjen në këmbë.

¹² Hashijetu Sunen: 4/84.

nuk janë të qarta, ose nuk aludojnë fare në lejim, ose nuk janë të sakta.

Argumentet që e ndalojnë këtë ngritje:

Ebu Mixhlezi tregon: Muaviu hyri në një shtëpi në të cilën ishin Ibën Amiri dhe Ibën Zubejri. Ibën Amiri u ngrit në këmbë, kurse Ibën Zuberi qëndroi ulur. Muaviu tha: Ulu se kam dëgjuar të Dërguarin tek thoshte: *“Kush dëshiron që njerëzit t'i ngrihen në këmbë le ta përgatisë një ulëse prej zjarri.”*¹³ Ky hadith vërteton ndalimin e ngritjes në këmbë, kur sheh ndonjërin, siç e shpjegon Ibën Kajimi¹⁴, i cili u zgjerua duke e argumentuar këtë gjë dhe duke iu kundërpërgjigjur atyre që mendojnë të kundërtën.

Enes ibën Maliku tregon: “Asnjë njeri nuk ka qenë më i dashur tek Sahabët, se sa i Dërguari. Ata kur e shihnin nuk i ngriheshin në këmbë, ngaqë e dinim se ai e urrente një gjë të tillë.”¹⁵ Nëse dikush dëshiron t'i ngrihen njerëzit në këmbë, ose hidhërohet nga mos-ngritja e tyre, atëherë s'ka dyshim në ndalimin e kësaj veprë, mirëpo meqë nuk mund ta dimë për askënd nëse dëshiron apo jo, dijetarët i kanë ndaluar të dy rastet, duke e konsideruar të dytin më të lehtë¹⁶.

Këtu dua të theksoj, se disa dijetarë, edhe pse nuk e ndalojnë ngritjen sipas formës numër shtatë, që u përmend më lart, prapëseprapë vërtetojnë se Suneti dhe praktika e selefit është mos ngritja¹⁷, siç thotë Ibën Tejmije¹⁸.

Është me rëndësi të dimë, se nëse mos-ngritja shpie në urrejtje dhe keqkuptime të mëdha, të dëmshme, atëherë duhet të ngrihemi duke bërë një të keqe më të vogël, në mënyrë që të mbrohem nga një tjetër më e madhe¹⁹. Po ashtu në këtë ndalesë

“...Nëse mos-ngritja shpie në urrejtje dhe keqkuptime të mëdha, të dëmshme, atëherë duhet të ngrihemi duke bërë një të keqe më të vogël...”

përfshihet edhe ngritja e nxënësve për arsimtarin. Porosia në këtë rast iu drejtohet mësuesve të mos kërkojnë një gjë të tillë prej nxënësve.²⁰ Për ta përmbyllur këtë temë nuk duhet lënë pa sqaruar edhe dilema që disa njerëz paraqesin, kur flitet për ngritjen në këmbë për shkak të njerëzve e ajo është: a konsiderohet adhurim ngritja në këmbë dhe a mund të krahasohet kjo vepër me rukunë dhe sexhden? Ngritja në këmbë bëhet në shumë forma dhe për shumë arsye. Disa prej tyre lejohen, disa të tjera preferohen, disa konsiderohen të urryera dhe disa të ndaluara rreptësisht madje konsiderohen shirk.

Nëse ngritja bëhet për të madhëruar dikë duke qëndruar te koka e tij, ky qëndrim nuk lejohet, nuk është kufër, mirëpo nuk lejohet. Ngritja në këmbë për një idhull, të vdekur, për ndonjë gur, dru apo objekt tjetër në mënyrën e adhurimit, ashtu siç bëhen rukuja dhe sexhdeja, kjo konsiderohet shirk i madh. Nëse ngritja në këmbë bëhet për të nderuar dikë, siç bëjnë nxënësit kur hyn mësuesi në klasë, kjo urrehet (mekruh). Nëse dikush ngrihet për të pritur mysafirin, në mënyrë që t'i shprehë mirëseardhjen dhe për t'i dhënë dorën, kjo lejohet.²¹ ■

¹³ Ahmedi, Ebu Davudi dhe Tirmidhiu, i cili thotë: hadithi është hasen.

¹⁴ El-Hashije ala Sunen Ebi Davud 8/93.

¹⁵ Ahmedi.

¹⁶ Tenbihul Enam ala mes'eletil kijam, Albani, revista El-Esale, nr: 20, viti: 1420h. Jordani.

¹⁷ Sahih Edeb el-Mufred, fq. 373.

¹⁸ Mexhmuul Fetava, 1/374.

¹⁹ Silsile Sahiha, 1/629.

²⁰ Ibën Baz “Mexheletul buhuth el-islamiye” 26/347.

²¹ Ibën Baz, Nurun ala derb.